


Me një krijimtari intensive në fillim të viteve '90, duke u renditur në krijueset e para femra të postkomunizmit, Lindita Arapi arsyen krijuese e sheh si domethënie për t'iu përgjigjur pyetjes: kush jam unë? Përgjigjja janë pesë vëllime poetike dhe dy romane, "Vajza me çelës në qafë" dhe "Çaste"

## LINDITA ARAPI

### E kam kuptuar vonë se femrës shqiptare i është dashur të jetojë në dy diktatura...



Portreti nga Ina Lajthia

#### FORUM MBI PËRKTHIMIN

HISTORIA E PËRKTHIMIT  
NË SHQIPËRI, PËR FAT  
TË KEQ, S'KA NJOHUR  
SHKOLLA TË MIRËFILLTA  
PËRKTHIMI

nga Aida Baro (fq. 4)

**"RETË E MREKULLUESHME..."  
TË RUDOLF MARKUT,  
NJË KOLEKSION I POEZISË  
NDËRKONTINENTALE,  
MË TË MIRË NË SHQIP**

nga Mimoza Ahmeti



#### ARKIV



AT FABIAN BARKATA  
DITARI I PANJOHUR  
SHQIPTAR, NGA NJË  
FRANÇESKAN  
AUSTRIAK

nga Ndue Dedaj (Fq. 12)



**BETEJA  
E LIBRAVE**

nga Jonathan Swift

(Fq. 14)

Romani - tipologjia e parapëlqyer e shkrimit  
letrar të Sterjo Spases

Behar Gjoka (Fq. 7)

Juan Rodolfo Wilcock, për herë të parë në shqip  
"Sinagoga e Ikonathyesve"

Arben Dedja (Fq. 11)

"Kronikat..." e Bashkim Hoxhës, analogjitetë  
ngacmuese mes heroizmit dhe intimitetit

Enver S. Morina (Fq. 6)

**LULE TË  
PAVENITURA**

përkthimet e rinisë së  
VEDAT KOKONËS



(fq. 9)

#### BIBLIOTEKË

**GLORIA  
IN EXCELSIS  
DEO**

ANNA KOVE





Me një krijimtari intensive në fillim të viteve '90, duke u renditur në krijueset e para femra të postkomunizmit, Lindita Arapi arsyen krijuese e sheh si domethënie për t'iu përgjigjur pyetjes: kush jam unë? Përgjigjja janë pesë vëllime poetike dhe dy romane, "Vajza me çelës në qafë" dhe "Çaste"

# LINDITA ARAPI

## E KAM KUPTUAR VONË SE FEMRËS SHQIPTARE I ËSHTË DASHUR TË JETOJË NË DY DIKTATURA...

Intervistoi: Violeta Murati

**Jeni poete, prozatore si edhe gazetare në Deutsche Welle. Çfarë do të thotë të mbetesh "në vendin tënd" edhe kur jeton në Perëndim?**

Shqipërinë e kam me vete, kudo ku jam në Europë, e unë nuk shpëtoj dot, edhe sikur të dua, sepse ai vend, ajo familje, ajo shoqëri e përjetime të atjeshme kanë formësuar në një masë të madhe atë që jam sot. Në këtë kuptim, jam gjithmonë "në e me vendin tim".

**Ju keni filluar të shkruani në vitet '90, si e kujtoni atë kohë, duhet të ketë qenë e vështirë për t'u orientuar për shkrimtarët, ishin momente të mëdha ndryshimi...**

Tani duket si një kohë e largët, por ka qenë një kohë mjaft intensive. Të gjithë kishim dalë të trullësuar nga izolimi, të merrje frymë si njeri i lirë pas diktaturës komuniste nuk ishte e lehtë. Disa zgjodhën politikën, se e kuptuan shpejt, në këtë rrumpallë shqiptare bëhet shpejt pasuria, pavarësisht retorikës që përdornin, disa i qëndruan vetes besnik e vazhduan rrugën e tyre në Shqipëri, të tjerë u larguan. Shqipëria vinte nga një

kohë kur shkrimtari ishte edukuesi i popullit, dora përkëdhelëse e diktaturës me fjalë, edhe nëse në këtë rol ai shtyhej pa dëshirë. Papritur, në një epokë kryekëput tjetër ai duhej të mbijetonte. Pikërisht në këtë kohë kam shkruar, ndoshta mënyra ime e të kuptuarit dhe përballimit të realitetit shqiptar. Një realitet që po ndryshonte shpejt, më shpejt se aftësitë tona absorbuese.

**Pra, ishin vite të kapërcimeve të mëdha, çfarë do të thoshte kjo për femrën?**

Vonë e kam kuptuar se femrës shqiptare i është dashur të jetojë në dy diktatura: atë të sistemit komunist që nuk e lejonte fjalën e mendimin e lirë, por edhe diktaturën e patriarkalizmit shqiptar, diktaturën familjare që krijoi me shekuj një model si duhej të ishte femra, cilit model duhej t'iu përgjigjej, ndëshkimet që e prisnin nëse nuk i përgjigjej këtij modeli, nëse rebelohej; të mos harrojmë, pjesë të kësaj diktature i gjen edhe sot. Por në vitet kur unë isha një vajzë e re, atmosfera ishte shumë shtypëse, të merrte frymën. Një atmosferë totale e frikës, ku nuk guxohej rebelimi. Asnjëra nga shoqet e mia nuk rebelohej, as unë. As në familje, as në shoqëri. Një rast rebelimi në qytetin tim të lindjes unë ende e kujtoj e më shoqëron fytyra e asaj vajze që u desh të humbte jetën për shkak të dashurisë. Kishte një dhunë kërcënuese në ajër për femrën, që kalonte shpejt në dorën e ngritur të patriarkut që kishte pushtet në atë moment në jetën tënde, që mund të ishte babai, vëllai, bashkëshorti. Gjithmonë pyes veten se çfarë do të thotë kjo atmosferë totale frike për personalitetin e femrës? Çfarë gjurmësh ka lënë ajo te femra shqiptare. Shumë vajza shqiptare të thonë që janë të duruara, të sakrificës, empatike, vetëmohuese më shumë se vajzat perëndimore, por çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se uni i tyre u deformua. Filozofja e njohur Julia Kristeva thotë se personaliteti krijohet nga rebelimi në adoleshencë. Të gjitha këto janë lënda ime që kam me vete nga Shqipëria, ajo është substanca ime, e nuk mjafton një jetë për ta përpunuar këtë lëndë në fjalë.

**Në këto kushte, si keni reflektuar ju vetë mbi lirinë?**

Kjo është një nga ato nocionet bazike, por për shkak të dimensionit që ka në jetën tonë, sa e shumëtrajtuar aq edhe e pakapshme është. Prejardhja, e kam fjalën për pjesën shqiptare të jetës sime, më bën të mendoj se unë do të jem gjithmonë në një marrëdhënie problematike me lirinë. Duke qenë se i kemi rrënjët në një vend ku liria ishte e lidhur me frikën, pasoja ishte edhe frika

nga liria. Liria është e mrekullueshme, por mund të jetë edhe një barrë, kur e ekzagjeron ose kur nuk di si ta mbash këtë dhuratë. Ajo kërkon të jesh e përgjegjshme me të, të kërkon të njohësh kufijtë e tu, të kërkon të respektosh edhe atë që nuk e duron dot tek tjetri, sepse kjo është liria e tij. Sot e kuptoj si një mundësi për të qenë vetja, ose më mirë, lirinë sot e barazoj me mundësinë për t'iu siguruar kohë vetes.

**Këtu desha të ndalem... a është një femër që shkruan gjithmonë në kërkim të kohës?**

Një femër që është nënë, fuqi punëtore, bashkëshorte, shoqe, sigurisht që është gjithmonë në kërkim të kohës. Madje vetëm kur e artikulon qartë kërkesën për kohën e saj, ka shansin ta sigurojë atë, ndryshe për t'ia dhuruar nuk ia dhuron kush. Gjërat janë komplekse, varësitë e ndryshme emocionale, ekzistenciale, janë armiqtë e kohës, që për dikë që shkruan është kushti i parë për të nxjerrë në dritë një punim.

**Letërsia ka shoqëruar jetën tuaj, edhe me largimin nga Shqipëria. Si ka rezistuar raporti me gjuhën, është jetë në ekzil kjo juaja?**

Shiko, unë jam ndier në ekzil edhe kur kam jetuar në Shqipëri. Edhe po të jetoja tani aty, ashtu do të ndihesha. Kur thua ekzil, aktivizohen asociacione të tjera. Të kujtohen emra nga Ovidi deri te Brecht e të tjerë. Ekzili sikur e përjashton mundësinë e kthimit. Për fat, unë kam këtë mundësi dhe jam shpesh në Shqipëri. Kur jeton në dy kultura, në dy gjuhë, je në një gjendje shkëmbimi të vazhdueshëm, edhe nëse nuk e vetëdijëson këtë përditë. Gjuha e nënës merr nga gjuha tjetër, në gjuhën tjetër reflektohen emocione gjuha të gjuhës së parë. E rëndësishme është në fund që përmbajtja të zërë vend e të ketë brumë.

**Vuajtja është asimetria në fytyrat simetrike të shqiptarëve të heshtur, që edhe pa i njohur më bien në sy që larg në qytetet simetrike të Europës... – pjesë nga poezia juaj, e mendoni Shqipërinë të lënduar edhe sot?**

Shqipëria është jo një vend i lënduar, por në lëngim sot. Po e kuptoj gjithnjë e më pak skizofreninë politike që sundon sot në Shqipëri dhe që i bën njerëzit në këtë vend të humbasin shpresën. Të gjitha palët duan Europën, të gjitha palët duan integrimin, duan zgjedhje të lira, duan më të mirën për popullin... po t'i dëgjosh në bazë të kësaj retorike, habitesh se si ato nuk kërcëjnë një valle dorë për dorë madje... Në Shqipëri mbajtja e pushtetit shihet si luftë për jetë a vdekje... Mund të pyesësh veten, pse krijohet kjo marrëdhënie me pushtetin, kush nuk do ta lëshojë kurrë pushtetin? A mos është ai që ka frikë se çfarë ndodh me të kur nuk e ka këtë pushtet? Po të kujtojmë skandalet në Shqipëri, kjo nuk më duket se është një luftë për kauzën e drejtë apo të gabuar, duket e vetëkuptueshme pse bëhet.

Më kujtohet, kur erdhi ndryshimi 30 vjet më parë, njerëzit kishin shpresë e thoshin se diçka do të ndryshonte. Edhe politikës i jepnin një shans, se vendi nuk bëhet brenda një dite, por sot ata e kanë humbur shpresën. Më trishton kur bisedoj aty me njerëz dhe thonë duam të ikim që sot, jo nesër. Duket sikur do të vijë një ditë e aty do të mbeten vetëm pleq të që nuk mund të lëvizin dhe politikanët. Kjo tregon se sa katastrofal ka qenë rezultati i punës së politikanëve shqiptarë. Pesë kulla e pesë rrugë nuk barazohen me humbjen e shpresës së një shoqërie, me humbjen e shpresës te rinia. Është absurde dhe ka kaluar kufijtë e normales armiqësia e grupeve politike në vend. Sigurisht që pas kësaj fshihen problematika të tjera, lufta për sigurimin e burimeve të ndryshme. Por një përgjegjësi, nuk duhet harruar, ka edhe votuesi. Ka të bëjë me zhvillimin e vetëdijes për demokracinë. Njeriu i vogël të vetmin mjet pushteti që ka kundër të fuqishmëve me pushtet është vota dhe këtë pranon ta







shesë? Kaq jo seriozisht e merr veten ky votues? I vetmi shpëtim për vendin qëndron te votuesi i ndërgjegjshëm, vetëm ai mund të dallojë politikanin e përgjegjshëm e të largojë kastën e të korruptuarve.

**Të kalojmë te romani juaj “Çaste”, një kolazh eksperimental, pse ndërruat temë nga përballja me diktaturën, portretizimi i femrës, ju i kushtoheni mitit të kalimtares në metropol, anonimitetit - ku ka një numër të madh njerëzish që aspirojnë të bëhen shkrimtarë, të suksesshëm...**

Ishte një ide që lindi po ashtu në një metropol. Duke ecur një ditë në një rrugë, rrëmujë, njerëz që ecnin pa e pasur mendjen te njëri-tjetri, si ata që dalin lumë nga metroja, pashë në rrugë një letër të bardhë me një numër telefoni, ku ishte shkruar: “Më telefono, të lutem.” Më bëri shumë përshtypje, se e pashë edhe disa herë gjatë asaj rruge. E mora një herë në dorë, por pastaj e lashë në rrugë, sërish. M'u duk një simbol i fortë i anonimitetit e vetmisë në qytete të mëdha europiane. Momentet fluide, të pakapshme në qytetet e mëdha, dyndja e njerëzve anonimë secili i kyçur në individualitetin dhe egoizmin e vet më kanë bërë përshtypje. Kush ishte ai ose ajo që hodhi një letër, një njeri në nevojë apo dikush që bënte edhe shaka, këtë nuk do ta di, por të paktën pas kësaj lindi ideja e një libri.

**Një libër me një shkrimtar, figura kryesore e romanit “Çaste”, tejet ironik ndaj vetes, ai nuk bën gjë tjetër vetëm se vëzhgon, ecën me autobus nëpër qytet, dëgjon historitë e të tjerëve, ndien dhimbje për të panjohurit kur në autobus kap copa bisede të dhimbshme. A është shkrimtari “hallembledhësi” i**

**botës, që pastaj këtë lëndë e kthen në letërsi për t'i bërë njerëzit të jenë më empatikë?**

Unë nuk besoj se letërsia ndryshon botën apo njeriun, por ajo ka mundësinë të të bëjë ty si lexues të ndjeshëm ndaj botës ku jeton, të rrisë sensibilitetin për jetën tënde, por edhe atë të të tjerëve, për marrëdhëniet ndërnyerëzore. Në këtë kuptim, ai që shkruan është “hallembledhësi” i botës, sepse ai të jep mundësinë të lexosh për jetë të tjera që nuk janë jeta jote, por që mund të ishin, për ngjarje apo probleme që nuk janë të tuat, por që mund të ishin të tuat. Shkrimtari të jep dimensionin universal përmes lokale, copëzës së një bote të vogël. Në këtë kuptim, të hap dritare të reja, të zgjon vëmendjen, sigurisht për atë që do të shikojë shumë botë, do të depërtojë në nivele më të thella të kuptimit të vetes e universit ku jeton.

**Domethënë letërsia është një lloj udhërrëfyeseje e njeriut...**

Ka miliona e miliona libra, aq sa sikur nga ky moment të mos hidhej më një rresht në letër, botës do t'i mjaftonin librat për një shekull. Të vërtetat dhe emocionet janë trajtuar e ritrajtuar, sa të duket se nuk ka më asgjë të re për të thënë nën këtë diell. Por, megjithatë, letërsia ekziston, letërsia e mirë të ngre peshë. Sepse gjatë atyre minutave të heshtura, i tërhequr për vete në lexim, fjala të tregon udhën drejt viseve të panjohura të vetes, të jep mundësinë të kuptosh substancën e thellë brenda njeriut.

**Nga vëllimi i parë e deri tek i fundit në mendjen e çdo krijuesi që veçohet nga të tjerët rri pezull pyetja: përse shkruaj? Përse shkruan Lindita Arapi?**

Po ta thosha thjesht e në mënyrë prozaikë, sepse nuk di


të bëj gjë tjetër më mirë. Po të flisja me termat e artit, do të thosha se çdo artist, qoftë i fjalës, qoftë i penelit apo videoinstalacionit, ka një veti, ai mban veshin te vetja, kjo besoj duhet të jetë e lindur, ndryshe nuk ka si të shpjegohet përumbja në botën e brendshme, që është një lloj kërkimi në fakt, se kur them mban veshin te vetja, nuk e mendoj këtë si një qorrsockak, por si proces krijues që tenton në fund t'i flasë botës jashtë, t'i thotë diçka duke i dhënë një produkt. E për shkak se shumë artistë e shkrimtarë janë egomanë të pandreqshëm, shpesh ata mendojnë se produkti i tyre është më i miri.

**Keni hartuar edhe një antologji me autorë shqiptarë, me poezi shqiptare botuar në Austri, quajtur “Kapërcimi i kufijve”. Pse nuk po ndodh, sipas jush, njohja e letërsisë shqiptare, ashtu si do të dëshironim?**

Nuk ka për të pasur njohje ashtu siç e dëshirojmë ne, por raste të veçanta; rrezatimi kulturor i një qarku të vogël mbetet i vogël, ne mund të zemërohemi ose t'i ngremë lavdi vetes brenda provincës sonë të vogël, por nuk duhet të harrojmë se bota është e madhe, ka dimensione të tjera... unë nuk e shoh me pesimizëm, sepse mjaft autorë shqiptarë janë njohur e botuar. Ndoshta dikur do të shkëlqejë edhe ylli i Nobelit për të na dhënë neve si letërsi më shumë rrezatim.

**Ju jeni edhe gazetare, punoni në Deutsche Welle, trajtoni edhe temat shqiptare apo të Ballkanit, ofroni për publikun shqiptar shumë tema europiane – a ju pengon apo ju ndihmon gazetaria – njihet kjo, shumë shkrimtarë në botë kanë punuar paralelisht si gazetarë për të siguruar jetesën...**

Në fakt, janë dy mënyra të ndryshme të punuari. Gazetaria më mban lidhur me realitetin e përditshëm, më krijon mundësi kontakti me njerëzit, më lidh me jetën. Kurse të shkruarit është një proces tërësisht ndryshe, që kërkon shkëputjen, izolimin, tendencën të krijosh me fjalë realitete që të jenë autentike, si realiteti ku sapo ishe pjesë. Nëse balanca mes të dyja këtyre fushave ruhet, është mirë. Nga ana tjetër, gazetaria ka rëndësinë e saj, edhe raportimi që bëjmë ne si Deutsche Welle në shqip nga Europa, është pjesë e programit tonë që të ofrojmë apo të shpjegojmë sa më shumë të mundemi Europën sot, nga këndvështrimet politike deri te historitë e njerëzve të thjeshtë në Europë, pra të japim një panoramë të plotë të asaj që ndodh sot në Gjermani dhe Europë.





Gazeta "ExLibris" hap forumin mbi përkthimin, duke ftuar shkrimtarë e përkthyes për të kontekstualizuar mbi përvoja personale tri çështjet themeltare të ardhjes së veprave të huaja letrare në shqip: Përkthimi: interpretim, përshtatje apo shqipërim?; Të përkthesh nga gjuha origjinale apo gjuhë e dytë!; Përkthimi: kulturë dhe gjuhë, sa rëndësi kanë? Këtë numër botojmë vështrimin e redaktores dhe përkthyeses Aida Baro

# HISTORIA E PËRKTHIMIT NË SHQIPËRI, S'KA NJOHUR SHKOLLA TË MIRËFILLTA PËRKTHIMI

nga Aida Baro

Në një poezi të poetes polake Wislawa Szymborska janë dy vargje, të cilat po i riprodhoj në italishte, duke qenë se gjuhën polake nuk e njoh: *Morire quanto necessario, senza eccedere./ Ricrescere quanto occorre da ciò che si è salvato.* Janë dy vargje që sa herë jam përpjekur t'i përkthej, asnjëherë s'kam arritur të ndihem e kënaqur me rezultatin. Të jetë, vallë, paaftësia ime si përkthyes? Apo mungesa e njohjes së gjuhës origjinale? Sidoqoftë, konteksti është i tillë: në det, ekziston një kafshë e quajtur kastravec i detit, i cili, për të hutuar dhe për t'i shpëtuar një grabitqari, ka aftësinë të ndahet me dysh, një pjesë që rrëmbehet nga grabitqari, por pjesa tjetër vijon të jetojë dhe të rigjenerohet.

Në njëfarë mënyre, kjo ndodh edhe me përkthimin letrar. Nuk ekziston një përkthim tërësor, i fjalëpërfjalshëm apo i përshtatur a i shqipëruar, në duam ta themi, që të mos humbasë diçka: çështja është çfarë dhe sa do të humbasë, në favor të kujt dhe sa do të fitojmë, për t'ia përcjellë tekstin lexuesit sa më afër asaj ç'ka dashur të krijojë autori. Në këtë kuptim, në përkthimin letrar duhet të ruhen patjetër kumti i autorit, atmosfera e tekstit, ose fryma siç më pëlqen ta quaj gjithnjë, dhe stili i autorit. Nuk ka rëndësi nëse zgjedhim një fjalë që nuk përkon pikë për pikë me atë që ka përdorur autori, për sa kohë që mendimi dhe atmosfera që ka krijuar ai na vjen e plotë. Në këtë rast, përkthyesi kthehet në njëfarë mënyre në krijues dhe mosbesnikëria kthehet në besnikërinë më të madhe.

Pikënisja ideale është, sigurisht, leximi kuptues i gjithë kompleksitetit të tekstit. Para së gjithash, një

përkthyes është një lexues i fortë dhe më pas një krijues. Gjatë procesit të leximit duhet të marrë një pozicion, pra të futet në lëkurën e autorit dhe të përpiket ta shohë ngjarjen a subjektin me qartësi sa më të madhe. Mirëpo, vija që e ndan rikrijimin nga përkthimi është shumë e hollë dhe kërkon një ekuilibër të madh nga ana e përkthyesit për të mos dalë mbi autorin. Personalisht, jam munduar gjithnjë të ndjek këmbë pas këmbë autorin përmes kuptimit të tekstit dhe kjo bëhet duke hulumtuar e duke bërë kërkime të shumta rreth tekstit që po përkthen, stilit të autorit, regjistrin që përdor ai, recensioneve të ndryshme apo studimeve që janë bërë mbi autorin.

Dëgjoj herë pas here përkthyes të ndryshëm që thonë "unë kam stilin tim", por a mund të ketë një stil të caktuar një përkthyes i mirë? Sigurisht që ai mund të ketë bagazhin e vet kulturor dhe leksikor, por këto duhet të vihen në funksion të autorit. Për shembull, nga veprat që kam përkthyer, autorë si Goliarda Sapienza, Primo Levi e Alberto Moravia nuk mund të kenë asses të njëjtin stil. Nëse Goliarda Sapienza, te "Muza e haresë" të "lë dorë të lirë" dhe mund të shprehesh me një fjalor të lulëzuar, shprehje frazeologjike pa fund, madje dhe të kuturisësh në dialekt apo të folme të vjetra, për Alberto Moravia-n në romanin "Përçmimi" (që do të botohet në shtator 2019) është më i rëndësishëm mendimi i lartë, por i shprehur qartë, me kthjelltësi dhe ndërjegje intelektuale; nga ana tjetër, Primo Levi tek "Armëpushimi" është tepër elegant në gjuhë, tepër aristokrat në ligjërime dhe tepër i sofistikuar në mendim, madje me një ironi kaq të hollë gati të pabesueshme. Tani, është e pamundur që këta tre autorë kaq të ndryshëm mes tyre të përkthehen në të njëjtën mënyrë, t'u vishen shprehje frazeologjike atje ku s'duhet, për hir të asaj që "shkon më shumë në shqip", të bësh të flasë me gjuhën e një intelektualit një fshatare të humbur si Modesta në fillimet e saj, apo të vësh në gojën e Levit, i rritur dhe i arsimuar me një italishte klasike, shprehje a fjalë popullore. Në njëfarë mënyre, përkthyesi, siç thotë Floberi: "duhet të jetë i padukshëm dhe i plotfuqishëm në veprën e vet, të ndihet kudo prania e tij, por të mos shihet asnjëherë."

Një nga përvojat e mia përkthimore përfshin edhe përkthimin audiviziv, filma dhe dokumentarë të ndryshëm. Kuptohet që secili drejtim ka elemente krejt të ndryshme nga përkthimi letrar. Ajo që në dukje ngjan më zbavitëse për njerëzit që nuk ia njohin vështirësitë, është kleçka më e madhe

për një përkthyes: filmat komikë. Në këta filma, është e pamundur të ruash trajtën e përkthimit letrar dhe domosdoshmërisht do të kalosh në përshtatje, madje edhe në shqipërim, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me një përkthim tërësisht kulturor: një batutë humorit e përkthyer fjalë për fjalë do të ishte një dështim i vërtetë, që nuk do të shkaktonte të qeshura te shikuesi, përkundrazi, do të shpinte në keqkuptim dhe keqpërkthim.

Kjo na shtyn të mendojmë se përkthimi, përshtatja apo shqipërimi nuk mund të ndahen me thikë dhe se duhet zgjedhur njëra prej tyre se s'bën, por qëllimi është të ruhet forma dhe përmbajtja e tekstit të përkthyer sa më pranë frymës dhe mendimit të tekstit në gjuhën burimore.

Një nga pyetjet më të shpeshta që më bëhen, është: "Cilën duhet të dish më mirë, gjuhën e huaj apo gjuhën shqipe?" Në fakt, një përkthyes që nuk di gjuhën e vet do të ishte një përkthyes i dobët, madje i keq; dhe këtu s'e kam fjalën për një bagazh fjalësh të mjaftueshme për përditshmërinë, por një njohje të thellë dhe rrënjësore të gjuhës amtare, e cila do të ndihmonte këdo në përkthim. Ka kaq shembuj përkthimesh të fjalëpërfjalshme të shprehjeve të huaja frazeologjike, të ngulitura tashmë në mendjen e të gjithë njerëzve, sa unë vetë ndihem si jashtë kohe kur u them gjegjësin në shqip. P.sh., shprehja "si qershia mbi tortë", e përkthyer nga italishtja "la ciliegina sulla torta" që ka kuptimin "në një situatë pozitive, i shtohet diçka që e bën edhe më të mirë" ka gjegjësin e saj të bukur në shqip "si lulja në thile", pikërisht, pra, lulja që zbukuron edhe më diçka që është tashmë e bukur, një veshje, një fustan, një kostum etj.

Kjo na sjell te një tjetër problem i madh në përkthimin e sotëm në gjuhën shqipe: te "përkthyesit e improvizuar" do t'i quaja, sepse me një vetëbesim të çuditshëm për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj, kuturisin të marrin përsipër përkthime letrare pa ia pasur idenë strukturës dhe sintaksës së gjuhës shqipe (gjëja minimale që duhet të mbajë parasysht një përkthyes) dhe përfundojmë me një tufë përkthimesh të anglishtëzuara, por me fjalë shqipe. Dhe këtu nuk po përmend "përkthyesit fejsbukorë", që nuk njohin mirë as shqipen e as gjuhën nga e cila përkthejnë, por thjesht se i kap mania e protagonizmit na zgjohen papritmas "përkthyes".

Edhe shtëpitë botuese ndonjëherë janë të detyruara nga rrethana të caktuara të përkthejnë një libër nga gjuha origjinale, por duke mos pasur përkthyes të mirëfilltë letrarë nga ajo gjuhë. Në këtë rast, dilema është e madhe: "Më mirë një përkthyes i dobët nga gjuha origjinale apo një përkthyes i mirë nga një gjuhë e dytë?" Nga ana tjetër, ka shumë gjuhë të tjera, si p.sh. islandishtja, norvegjishtja, japonishtja etj., për të cilat nuk kemi përkthyes as të mirë, as të improvizuar. Ngrihet pyetja: "A do të duhet të përkthejmë letërsi nga këto gjuhë?" Apo është më e mirë mosnjohja e letërsisë së këtyre vendeve? Unë do të preferoja një përkthyes të mirë dhe të përgjegjshëm nga një gjuhë e dytë, me gjithë rreziqet e keqkuptimeve që mbart kjo punë. Në këtë rast, përkthyesi nga gjuha e dytë mund edhe të përdorë një tekst krahasimi nga një gjuhë tjetër, për të qenë në njëfarë mënyre i sigurt për atë çka nxjerr nga duart.

Historia e përkthimit në Shqipëri është shumë e afërt dhe, për fat të keq, nuk ekzistojnë shkolla të mirëfillta përkthimi, për më tepër të përkthimit letrar. Pra, në njëfarë mënyre, përkthyesit letrarë kanë zgjedhur ta bëjnë këtë punë herë për pasion, herë për hir të patriotizmit për të pasuruar kulturën shqiptare me autorë të vyer, siç bëri Noli me Shekspirin, apo siç ndodhi me përkthimet e pjesshme apo të plota të Homerit, të përkthyer nga Pashko Gjeçi, të cilat zor se mund të përsëriten më. A do të duhej të ripërktheheshin? Patjetër, sepse gjuha është organizëm i gjallë, ndryshon nga brezi në brez, jo më ndër gati një shekull diferencë, por nuk mund të hidhen në turrën e druve të gjithë ata që kanë punuar në këtë zeje kaq të vështirë dhe të keqshpërblyer, si atëherë, si sot.





Titulli i Antologjisë është frymëzuar nga vargjet e Baudelaire, "I huaji"- Ai nuk ka: as nënë e as baba, as motër e as vëlla, as miq e as atdhe, dhe e urren arin po aq sa dhe Zotin, por Ai, i huaji, dashuron retë...retë e mrekullueshme...

# RUDOLF MARKU

## RETË E MREKULLUESHME... NJË KOLEKSION I POEZISË NDËRKONTINENTALE, MË TË MIRË NË SHQIP

nga Mimoza Ahmeti

Nuk reshtin së shpalluri fundin e Poezisë, por ajo shfaqet gjithmonë e re dhe tronditëse në postbloquent politike "të mbarimit". Si një festë kuptimesh, e veshur me rekuizitë të një gjuhe të re e me melodi sinapsesh, kjo muzë është e vetmja që siguron freskinë e sagave dhe pastron shpirtin nga myku i vetëpërdorimit normativ.

Mijëra definicione dhe asnjë ngërthyes për të. Poezia është një medium që çliron gjithë lëndën, pasi nuk e damkos atë, si arsyeja, por e shpërbën me metafora hiçin e demarkacionit me të cilin është krijuar shpirti!

Befasues, një rrengëtar i limitit, shfaqet Rudolf Marku në seleksionin që ka bërë. Duke prurë poetë nga të gjitha gjuhët, pa bërë dallime, por gjithashtu duke dalluar më të mirën, tek autorët e mëdhenj, ka ndërtuar një unitet metastruktural, që kalon urë mbi urë nëpër kultura, duke kapërcyer kohëra dhe gjeografi, për të dhënë në mënyrën më të thjeshtë një rruzull intrinsik në këtë përmbledhje impresionuese e transformuese, ku përkthyesi shkrihet me poetin, për lexuesin.

Titulli i Antologjisë është frymëzuar nga vargjet e Baudelaire, "I huaji"- Ai nuk ka: as nënë e as baba, as motër e as vëlla, as miq e as atdhe, dhe e urren arin po aq sa dhe Zotin, por Ai, i huaji, dashuron retë...retë e mrekullueshme...

Poet i eksplorimit të shpirtit dhe i ndriçimit të plehut të tij, prej të cilit rritet e ndodh lulëzimi i luleve të së keqes, Baudelaire, në mënyrë të pamëshirshme por përgjithësuese na zbulon vetëdënimin që i bëjmë vetes, jo thjesht kur e kryejmë mëkatin sesa kur e vuajmë atë dhe pendohe mi, pasi bota unifikohet kur ndërjegjija nënështrrohet, pajtohet me dënimin:

*"Gabimet, kopracia, mëkati, marrëzia,  
na pushtojnë në shpirt e na mendojnë në trup,  
ne ushqejmë pendimet tona më në fund,  
siç ushqejnë lypësat morrat, me mijëra".*

*Është djalli ai që na lëviz gjithë qenien tonë,  
me sendet e neveritshme joshja na kap,  
çdo ditë drejt Ferrit zbresim nga një hap  
pa tmerr, mes Ferrit që kutërbon.*

*Si një i çthurur varfanjak që puth i dehur  
gjirin e mundur të një kurve plakë,  
ne vjedhim ndonjë kënaqësi kalimthi si tinëzakë  
dhe e rrokim fort si një portokall të mshebur...*

Për të vazhduar të njëjtën ide në një rrethanë të re formulimi, poeti Britanik, Thomas Eliot, derdhet radikalisht në vargjet e poemës së tij: "Këngë dashurie për Alfred Prufrock":

*"Dhe prapë kohë për njëqind ngurrime,  
për njëqind shikime dhe rishikime...  
Të pyesësh me çudi: A do të guxosh? Dhe: A do të guxosh?"*

*A do të guxoj-  
Universin të shqetësosh?  
Një minutë ka kohë  
për vendime dhe rishikime që, po brenda minutit, asgjë  
të mos mbesi...*

*Sepse tashmë i kam njohur të gjitha, të gjitha i kam  
njohur,  
i njoh zërat që shuben në një kadencë që vdes,  
Kam matur jetën time, me lugën e kafesë...  
Ta shtrydhim Universin si një lëmshe  
duke e rrokullisur me një frazë, që të luan mendsh:  
e cila thotë: "Jam Lazari, prej së vdekurish jam kthyer,  
jam rikthyer, të gjitha- për t'jua dëftyer..."*

Qysh prej shekulli apo edhe më parë, por jo në një dimension kaq të gjerë social si sot, shtrohet pyetja: a është njeriu që e prodhon shoqërinë e këtij lloji, apo kjo e fundit e klishon njeriun kësishi?

Kësaj pyetjeje, thuajse në një mënyrë flegmatike dhe pa retorika, me tone të urta vetëqortimi, i përgjigjet Kavafisi i dashur, poezia e të cilit të rreshqet thellë si mëndafsh nëpër trupin monoton të kohës:

*Ti thua: "Do shkoj në një qytet tjetër, në brigje të tjera,  
të gjej një qytet më të mirë se ky.  
çfarëdo që të bëj, fati ma kthen mbrapsht  
dhe zemrën e kam sikur ta kisha të  
vdekur.  
Sa kohë më tepër do e të shpirtin të kalbet  
në këtë vend?..."*

Këtu ku kalova pjesën më të madhe të viteve të mia, duke i shkatërruar dhe i shkuar dëm...

*Ti nuk do gesh vend tjetër dhe as brigje  
të tjera  
Ky qytet gjithmonë ty ka për të të ndjekur.  
Do ecësh...  
Do ecësh të njëjtat rrugë...në të njëjtën  
shtëpi do të thinjesh...  
Siç e shprishe jetën këtu, në këtë qoshe të  
vogël,  
ti e ke shprishur atë në çdo vend tjetër  
të botës.*

Duke iu kthyer veçorisë së poezisë dhe gjuhës së saj, le të citojmë filozofin e qenies, Heidegger, që thotë për poezinë, në raport me gjuhën në tërësi: Gjuha, në vetvete është poezi, në sensin esencial. Por qëkurse gjuha është gjithashtu truall në të cilin qeniet njerëzore zberthejnë veten, në çdo herë si qenie, poezia mbetet

sensi më i hollë dhe forma më origjinale e esencës së sensit. Gjuha nuk është poezi, sepse është poezia e parë; në të vërtetë poezia zë vend në gjuhë sepse gjuha e ruan natyrën origjinuese të poezisë. Është hapja e gjuhës që e mbush poezinë; në hapjen e thënies ndodh emërtimi, duke vënë të vërtetën në veprim, duke nxjerrë në dritë atë që ka ndodhur e nuk është vënë re ende në gjuhë.

Duket se gjuha dhe jeta udhëtojnë bashkë për të dhënë qenie. Në poezinë lirike metafizike të Borhesit gjuha shkrihet nga dashuria për jetën:

*Manuel Flores shkon të vdesë...  
Vdekja është një monedhë që ecën,  
vdekja është një zakon,  
që ndonjëherë e kanë njerëzit.  
E megjithatë, më vjen keq,  
t'i them jetës: lamtumirë,  
kësaj gjëje, përgjithmonë,  
aq të ëmbël, aq të mirë...*

I vetëdijshëm për të gjitha dimensionet: gjuhë, qenie, jetë, vdekje, pasvdekje, në Artin poetik, Borhes vazhdon:

*Të shohësh Lumin që është prej kobe dhe uji,  
e të kujtohesh se koha është një tjetër lumë,  
të dish se ne humbasim si një lumë  
dhe radha jonë kalon si uji...*

E prapë duke iu referuar Hedeggerit, për të perifrazuar atë që përvoja e qenies kupton në poezi dhe e rikrijon në të: Njeriu rron në atë që ndërton, dhe ajo që ndërton i jep atij sensin. Njeriu nuk rron duke ndërtuar ndëjtjen e tij në tokë poshtë qiellit, duke rritur e ngritur gjërat ashtu si ngre binatë (ndërtesat). Njeriu është i zoti të ndërtojë vetëm aq sa ka ndërtuar në masën e sensit poetik. Ndërtesa është autentike, saç është edhe poetike. Poetët janë masa e arkitekturës së banimit individual-qenësor.

Duke falenderuar përkthyesin dhe poetin e njohur, Rudolf Marku, për këtë konstelacion poetik-konceptual qëllues, si dhe shtëpinë botuese Mapo për botimin e saporealizuar, 2017, shpresojmë se sadopak kemi prekur shqisën poetike të lexuasit, në apelin modest me këtë shkrim, kundrejt të gjitha llojeve të mediave gjithashtu, për të kthyer kujtesën dhe vëmendjen drejt poezisë, burimit të të gjitha burimeve.



# "KRONIKAT..." E BASHKIM HOXHËS

## ANALOGJITË NGACMUESE MES HEROIZMIT DHE INTIMITETIT

*...Në romanin "Kronikat e mjegullës", si vetë kapërcimet fragmentare e të mjegullta, vijjnë personazhe të njohura edhe nga historia e kombit shqiptar...*

nga Enver S. Morina

Autori i romanit "Kronikat e mjegullës" shëtit nëpër rrugët e Durrësit. Shtëpia e tij është teatri, është studioja e një programi televiziv, është dhoma e shkrimit. Dikur redaktor në Kinostudio. Ky ishte shkasi i takimit të parë me një intervistë për ekranizimin e veprave letrare në filmin artistik shqiptar. Të gjithë e njohin Bashkim Hoxhën. Dhe pyetja ishte e çastit. Në një nga rrugët e kryeqytetit i rikthehem gazetarisë dhe pyes kalimtarët me një lutje, mirësjellje, duke shpjeguar se nuk jam "kamera e fshehtë", por një ish-gazetar që do të doja të dija nëse kishte njeri që nuk e njihje Bashkim Hoxhën. Rrugës i vjen fundi, por nuk përfundonin ata që njihnin shkrimtarin, gazetarin. Iu shmanga një çifti, me gjasë turistësh, të cilët vetëm më përshëndetën duke më ndihmuar që të mos ua prishja atë ambient të pastër diellor në pranverën e hershme të Tiranës.


Në pritje të romanit të ri? Pikat e pritjes janë enigmatike në prozën e sotme në përgjithësi, sidomos në letërsinë e cila zhvillohet në Kosovë. Asnjë nga ata nuk janë shkrimtarë të mirëfilltë, ta zëmë prozatorë. Nëse njëri ka ardhur nga kritika, tjetri ka ardhur nga gazetaria. Nuk di në letërsinë shqipe të sotme që dikush të ketë botuar roman "të mirëfilltë", nëse nuk është nisur nga një përvojë, ta zëmë nga gazetaria, publicistika a nga kritika e eseistika.

Paralexim fragmentar, si "dalje" nga romani: kryepersonazhi Hënë, me të cilën ndërlihet e tërë ngjarja dhe rrëfimi, përmyll historinë e humbjes së virgjërisë, zhvirgjërimi me çepjen e saj, si një odisejadë çepje historia për gjysmë shekulli, si thelb i përmbajtjes a më afër një shekulli të tërë si krijim i autorit, si përfundim i ngjarjes. Në 21 pjesët e emërtuara, a 21 kapituj siç i ka ndarë autori, ka në emërtim emra personazhesh kryesore (Hëna, Azis beu, Ferdinandi etj.) dhe një pjesë në mes me emër vendi (Qyteti i fundit). "Ndërhyjnë" në disa faqe dromca nga përmbajtja e mjegullës (Buletini i mjegullës, Horoskopit i mjegullës...) Një kapitull ka emrin "Mjegulla".

Dromcat fragmentare dhe eseistike të rrëfimit të historisë herë-herë çrregullojnë vijën lineare e homologe, gjithëherë në përballje me personazhin e Hënës. Në tri pjesët e para me emra personazhesh (Hëna, Azis beu, Masari) personazhi kryesor Hëna jeton çaste metamorfoze jetësore të pakompromis: vdekja e nënës, amaneti i nënës, zhvirgjërimi, martesja dhe ikja nga bota në të cilën kishte kërkuar të futej me qenien e saj. Personazhi i Hënës që ndërton identitetin e saj, e kërkon fatin apriori, por që sfidohet nga jashtë, nga të tjerët, aq lehtësisht, saqë vazhdon më tej sipas amanetit të nënës, mentalitetit në krahina të ndryshme. Përshkrim dhe gjuhë e thjeshtë në aventurën e konfliktit të personazheve dhe pasazhit të ngjarjeve. Për Cubin, natyra qenësore në rrjedhën e kohës dhe fatin ekzistencial është mjegulla. "Një ditë ndeshje me një të arratisur, një ditë tjetër me një karvan, një ditë me një grup ushtarësh, të cilëve u përvidhej po nëpër mjegull". Është parashikimi i "motit" se "çfarë do na

sjellë mjegulla". Si nëpër legjenda. Nga mitologjia, si te "Lugjet e verdha", deri te një vit më pas ngjarjeve, si te "Viti i mbrapshtë". Tipike përmes "unitetit" krahasimtar: Fatkeqësia që ndan Cubi me kafshët e egra ishte gjuetia e njerëzve. Në zonat më "të errëta" me ligjin e tejkaluar dhe që të bind dhunshëm për të mos e thyer, Cubi "jetonte në vendin e nëmur dhe asgjë e keqe nuk i kishte ndodhur. Përkundrazi, gjërat e këqija u kishin ndodhur të tjerëve". Mikrostruktura e tekstit shpjegues, në tematikën e universit perandorak, ngulmon si toponimi krahasimtarë dhe analogjike.

"Kemi gjuhën më të vjetër në botë dhe na duhet të ligjërojmë në gjuhë shkretëtire", - thotë personazhi "karizmatik" Nesti. Autori luan, zëvendëson fjalën përjashtim ose dëbim si një lojë gërshetimi ligjërimor. Thelbi i fjalës "sikteris" me "s" prapa dhe pas zanores "i" të theksuar vjen e bëhet veprues "sikur me këtë fjalë të kishin qëlluar me kamxhik e të kishin çuar larg, shumë larg". Gërshetimet tematike ndikojnë tek analogjitë ngacmuese mes heroizmit dhe intimitetit: Mjegulla dhe akti i shpalljes së Pavarësisë dhe Mjegulla dhe aktet seksuale të Hënës. Në kërkim të një krehri e pasqyre Cubi "mëson" për shpalljen e pavarësisë dhe ikjen e turqve. Autori, rrëfyeti, thotë se topat dhe kuajt ikin, por xhamitë mbesin. Ikin edhe ushtarakët. Kapërcimet fragmentare janë historike, të një rrjedhe historike! Nga Faik Konica tek Atë Gjergj Fishta! Në gjenealogjinë e politikës qeverisëse të shtetit shqiptar vijnë dhe shkojnë pak emra, si Ismail Qemali, Fan Noli, Ahmet Zogu... Fati i tyre deri në vitin 1936, kur personazhi Misto N. merr përgjegjësinë për të shkruar historinë, tashmë dihet. Kronika e Mistos nuk i ngjan mjegullës, përkundrazi, është një rrëfim historik me të kundërtën e së vërtetës që edhe pasqyra do të irritohej nga fjalë aq të mëdha patriotike. Një fikson për çështje historia?! Një rrëfim për historinë gjysmëshekulli çështje?! Gënjeshtra rrëfimore në kërkimet për historinë e shqiptarëve. Deformimi i së vërtetës vazhdon saqë edhe lexuesi mbetet në mjegull. Romani "Kronikat e mjegullës" vjen e bëhet një hyrje në historinë shqiptare të shekullit XX.





# ROMANI - TIPOLOGJIA E PARAPËLQYER E SHKRIMIT LETRAR TË STERJO SPASSES

nga Behar Gjoka

Trashëgimia shkrimore e Sterjo Spasses, e autorit të dy periudhave të shekullit të kaluar, të viteve '30 dhe të pas Luftës së Dytë Botërore, ka nisur me shkrimet publicistike, e pastaj ka vijuar me botimin e tregimeve dhe novelave. Qysh në krye të herës, bien në sy dy prirje: së pari, një përpjekje e vyer për të sjellë atmosferën e jetës sociale, përmes kritikës së hidhur; së dyti, aty shfaqen shenja të rrokshme të realizmit kritik, që përmbledhet në këta libra: *Kuror rinie* (1934), *Në krahët e një femre* (1934), *Nusja pa duvak* (1944) dhe *Të fala nga fshati* (1958). Krahas teksteve të shumta mësimore dhe disa përktitimeve, si përvojë shkrimi, të krijimtarisë letrare, përvoja shkrimore e Spasses mbizotërohet nga lëvrimi i romanit. Tipologjia e këtij lloji letrar, që në fillësë, bëhet vatra kryesore e letrares, endur nëpër kohëra, madje në kapërcyellin e 100-vjetorit të lindjes së autorit shndërrohet në shenjë përfaqësuese të krijimtarisë së tij, si dhe në një artefakt të përveçëm që bashkëshoqëron evoluimin e romanit. Sugjerimi i Milan Kunderës, te libri *Arti i Romanit*, kur nënvizon se "...bota e kohëve moderne lindi dhe bashkë me të, edhe romani me imazhin dhe modelin e tij..." vetvetiu të krijon gjasat e kërkimit të fillimit të romanit shqiptar, të ndihmesës së Sterjo Spasses, që zë fill me kryeveprën e tij, romanin *Pse?*. Ky tekst u bë pjesë e klimës letrare të viteve '30 të shekullit të kaluar ku, siç thekson Robert Elsie, përveç botimeve të tjera të periudhës, në fushën e prozës shqiptare u botuan: romani nihilist *Nga jeta në jetë - Pse?!*, Korçë, 1935, nga Sterjo Spasse.

Kuptohet se kontributi i S. Spasses në marrëdhënie me gjuhën dhe letërsinë shqipe, siç e kanë shqyrtuar studimet letrare, kohë mbas kohe është lëvrimi gjerësisht i romanit, që shkon në dhjetë tekste romanore dhe që konfigurojnë arritjet e autorit. Depërtimi në hapësirat e teksteve të prozëshkrimit, pa mëdyshje që do të kërkonte një punë të thelluar të institucioneve dhe studimeve letrare, për të shijuar kështu mozaikun e sendërtimit të këtyre romaneve. Kohështrirja e shkrimit, po kaq edhe tipat e ndryshëm romanorë që realizohen nga autori, e bëjnë të pashmangshëm, ravijëzimin e fillimit dhe të kontureve që përfaqëson romani i S. Spasses. Romani si tipologji ndërkohë pëson ulje-ngritje, por romani si lloj letrar asnjëherë nuk ndërpritet si proces dhe parapëlqim i autorit. Shqyrtimi i botës romanore, ku ndeshim sproven dhe eksperimentin, dritat dhe hijet, aspiratën dhe dëshmitë artistike, edhe në këtë qasje përgjithësuese do të vështrohet në disa pamje dhe pista hulumtimi: parim i verifikimit simbas kronologjisë së botimit; problematika që përcjellin tekstet e romaneve; tipologjia dhe format e llojit letrar; vendi që ka proza e autorit në letërsinë shqipe. Varësisht kohës së shkrimit, bashkë me praninë e gjithkohshme të lëvrimin të romanit, si tipologji e parapëlqyer, romani shtrihet në dy kohë: a- Romani i shkruar para viteve 1944: *Pse?* (1935), *Afërdita* (1944), të shekullit të kaluar; b- Romani që shkruhet pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, *Ata nuk ishin vetëm* (1952), *Afërdita përsëri në fshat* (1954), *Buzë liqenit* (1965), *Zjarre* (1972), *Zgjimi* (1973), *Pishtarë* (1975), *Ja vdekje ja liri* (1978) dhe *Kryengritësit* (1983). Vështrimi kronologjik, aspektet

që bartin tekstet, është më i gjerë dhe më i ndërlikuar. Shtjellimi i trashëgimisë letrare, në bazë të brendisë dhe tipologjisë shkrimore, ka gjasa që të na japë dorë për të depërtuar në universin e tyre. Prandaj përvoja e shkrimit të romaneve të tij mundet të kundrohet në varësi të problematikës që përcjellin tekstet: romane sociale, filozofike, të lëvizjes feministe të kohës, ku futen *Pse?*, *Afërdita*, që rimerret në kontestet e monizmit, me tekstin *Afërdita përsëri në fshat*. Me këtë ndërlikohet, me gjendjen që pohon Robert Elsie, përmbledhja e dytë e tregimeve të Ernest Koliqit, *Tregtar flamujsh*, Tiranë, 1935; romani i mirëpritur i kritikës sociale, *Sikur të isha djale*, Tiranë, 1936, nga Haki Stërmilli; dhe vëllimi i parë i tregimeve të Mitrush Kutelit, *Netë shqipëtare*, Bukuresht, 1938. Edhe Migjeni botoi... *Novelat e qytetit të Veriut*, 1936. Së fundi, Republika Culli e vendos në një kontekst më të plotë shkrimin e romanit *Pse?*, kur shprehet: "Menjëherë pas botimit të këtij romani do të pasonin romane të tjerë me përmbajtje të fuqishme sociale dhe me tematikë aktuale, si *Sikur të isha djale* e H. Stërmillit, *Gremina e dashurisë* e M. Greblleshit etj." Përfshirja e Spasses në shtjellat e realizmit socialist, që nisat me romanin *Ata nuk ishin vetëm* (1952), që bashkë me romanin *Çlirimtarët* të Dhimitër Shuteriqit, promovojnë tipin e romanit të realizmit socialist, si dhe me ribotimin e *Afërdita përsëri në fshat*. Lidhur me këtë situatë, S. Hamiti në librin *Letërsia moderne shqipe* shkruan: "...veprat që Spasse shkruan mbas Luftës së Dytë Botërore, nuk lidhen as tematikisht dhe as me stil me veprat e periudhës së parë të krijimtarisë së tij letrare." Përpjekja e S. Spasses për të ikur prej realizmit socialist, me romanet *Zgjimi*, *Pishtarë*, *Ja vdekje ja liri*, *Kryengritësit* dhe *O sot, O kurrë*, ku ndërton një situatë epike të mirëfilltë, i cila ka si epiqendër epokën e Rilindjes, duke realizuar kështu një sagë romanore të Rilindjes, me gjasë një sagë përlindëse të kombit shqiptar. Këto romane përplotësuan tiparet e realizmit në letërsinë shqipe, si dhe formësuan shenjat e romanit shqiptar të pasluftës dhe janë një pasqyrë e një epoke historike dhe letrare jetike për mbijetesën e botës shqiptare. Ato kanë vlerën e një dëshmie dhe procesi letrar, që megjithatë pati prurjet dhe kufizimet e saj. Vështrimi, kronologjik dhe përmbajtësor është i pamajftueshëm, për të hyrë në brendësi të materies letrare. Verifikimi i vlerave, bazuar në këtë tipologji, ka mundësi që ndihmon për të mbërritur në përfundime më të sakta. Vihet re se në trashëgiminë letrare të autorit kemi një larmi të tipologjisë shkrimore. Kështu me romanin e parë *Pse?* autori ka hedhur bazat e romanit psikologjik, filozofik dhe me jo pak shenja të romanit social. Ndërkaq, vetë struktura tekstore, konfigurimi i personazheve, magjia e shprehësisë, e radhit tekstin në fillesat e modernitetit të lëvrimin të romanit. Një tip tjetër romani sendërgjon libri *Afërdita në fshat*, që përkon me lëvizjen feministe, pra duke shënuar një roman social, me anësim të rrokshëm psikologjik.

Në varësi të objektit të përcaktuar, cikli i romaneve për Rilindjen, ndërkaq ravijëzon tiparet e romanit historik, ndonëse imagjinaria sërish ka peshë specifike të përfillshme. Pavarësisht njohjes që mundësojnë rrafshet kronologjike dhe tipologjike, përvoja e shkrimit letrar të Spasses vetvetiu të ofron edhe diç më tepër. Esenca e tjetërsojshme dhe intenca estetike lidhet po ashtu edhe me larminë e formave shkrimore, pra edhe me llojin letrar, tashmë si një formësim përfundimtar. Në këtë këndvështrim, qysh në krye, bie në sy: romani *Pse?* është një prozë e gjatë, realizuar në formë ditari, që pasohet nga shkrimi i romanit ditari, *Sikur të isha djale* të Haki Stërmillit, që shpallon dukshëm lëvizjen feministe të kohës; romani realist, në metodë dhe parashtrim, me kahe të një kritike të ashpër ndaj fatit të femrës, në periudhën para pushtimit fashist, ku përfshihen *Pse?*, *Afërdita*; romani i realizmit socialist, ku vihet re tendenca për të mishëruar tiparet më kryesore të modelit zyrtar, që përfaqësohet nga *Ata nuk ishin vetëm*, *Afërdita përsëri në fshat* etj.; romani realist me një rezonancë historike që, megjithatë, lëvrohet në gjirin e letërsisë së realizmit socialist, ku hyjnë *Zjarre*, *Zgjimi*, *Pishtarë*, *Ja vdekje ja liri*, *O sot, o kurrë* dhe *Kryengritësit*. Megjithatë, optikat shqyrtimore të shpien natyrshëm te një çështje thelbësore: cili është vendi që zë vepra romanore e Sterjo Spasses? Tipologjia e lëvrimin të romanit, e parapëlqyer nga S. Spasse, si një tregues i rritjes së letërsive kombëtare, pra edhe i letërsisë shqipe, përpos se përfaqëson shenjë unike të letrares së autorit, po ashtu është edhe shkasi për të diskutuar për rolin dhe vendin që do të zënë në letrat shqipe romanet e shkrimtarit S. Spasses. Studimet letrare, koha që ka rrjedhur, nga koha e botimit të romaneve të autorit, studimi real dhe përgjithësisht të përciptë, në fakt, kanë projektuar dy përfundime kryesore: 1. fillimi i modernitetit të shkrimit ndryshe të prozës shqipe, sidomos të lëvrimin të romanit, sido që të hartohet një antologji e letrave shqipe, nuk mundet të kuptohet pa tekstin e romanit *Pse?*; 2. Rilindja, tashmë si një përmasë ideale frymëzimi, na vjen e gdhendur në ciklin romanor të autorit, për këtë periudhë, madje në një formë të gërshetimit të faktikes dhe imagjinare, unike në letrat shqipe. Përvjetori i 105-të i Sterjo Spasses është një shans leximi dhe reflektimi, po kaq është një shkas për ta vendosur veprën e gjerë letrare, pedagogjike dhe publicistike, e veçmas romanet e tij, aty ku i takon, si pjesë thelbësore e vetëdijes gjuhësore dhe letrare, si vatër e vetëdijes dhe lartimit të genit shqiptar.





(X1)

Karma është kurvë e madhe, më tha Julia atë ditë kur u ktheva nga takimi im i parë. Karma? Po, po. Ajo i ka fajet të gjitha. Julias i pëlqente shumë të filozofonte. Unë nuk ia kisha ngenë edhe aq shumë. Ç'më duhej të dëgjoja filozofime dashurore, sidomos asokohe? E çdo takim të parë, përveç ditës, ka edhe shumë gjëra që e bëjnë pjesë të pashlyeshme të kujtesës. Ç'ditë e javës ishte, nuk e mbaj mend. Duhet të pyes Julian. Vendi? Ah, vendin poooo. Vendi përbënte ngjarje më shumë se dita. Bari i njohur në qendër të kryeqytetit, me emrin që Julias i pëlqente fort; me siguri i kujtonte se edhe emri i saj ishte i lavdishëm, po aq sa i barit. Pse duhet të takohemi gjithmonë këtu, e pyesja sa herë ajo kapërcente shkallët dhe u rëndonte takave me forcë, aq sa të gjithë të kthenin kokën, thua se zhurma e këmbës së saj mbi mermer ishte zhurma e skeptrit mbi tokë, kur mbreti paralajmëronte vendimin e radhës dhe të gjithë duhet të ndalnin frymën. Ndaj vinim gjithmonë aty... shkallët ishin të shtruara me tapet të kuq e parmakë të artë. Për t'u ngjitur te kati i dytë i barit, ku ishte edhe një dritare e madhe që të lejonte të tymosje, duhet të ngjisje gjithë ato shkallë, e ndjekur nga vështrimet kureshtarë nga poshtë lart të klientëve të shumtë, që zinin tavolinat e katit të parë. Ky ishte akti i parë i shijimit të lavdisë, thoshte Julia. Pastaj akti i dytë ishte ai i shijimit të kafesë më cigare. Dhe i treti? Ajo thoshte i bisedave tona.

- Edhe pak e mbërrij tek ti, - dëgjoja në telefon zërin e tij të plotë, ku ndihej edhe paksa tension në frymëmarrje.

- Po të pres, - i thashë unë me zë të dridhur.

- Ku po më pret?

- Ku? Si Ku? Te "Gloria", pra, - i thashë në të qindtat e sekondës. Nuk e di se si e pata ashtu atë ndjesi, se njerëzit nuk duhet të pyesin për gjëra që dihen. Ai, edhe pse nuk e kishte idenë se ku ishte "Gloria", më tha:

- Mirë, do të të gjej edhe ty edhe "Glorian".

Dhe na gjeti. A ishte dashuri me shikim të parë? Jo... Nuk ishte krejt ashtu. Madje, kam qeshur disi, kur kam ndier shikimet grishëse, sytë e lëngështuar që zor të kuptojë dot në shkëlqenin nga instinkti apo vinin nga thellë shpirti. Unë isha qenie dyshuese sa i takonte dashurisë me shikim e parë, por krejtësisht naive sa i takonte magnetizmit etik të herës së parë apo atij drithërimi kënaqësie estetike, po të herës së parë, që më përcillej si imazh ndjellës. Ah, ja ato më godisnin në zemër, më bënë të gëzoja fort: magjia e fjalëve, lojërat e emocioneve; gëzimi i pranisë, kur fjala bëhej mish. Dhe kjo më çmendte e gëzonte, thua se ngjizej në ndonjë altar diku të padukshëm dhe që vetëm me shpirt mund ta shikoja, ta përjetetoja. Si vinin ashtu këto ndjesi të thella deri në thelb të zemrës, sa të magjepseshe nga forca e elektricitetit që ishte aty, madje i fortë deri në rrezatimet e syve dhe i bënte ata të ishin të verbër. Krejtësisht të verbër.

- Mojt, po ti pse je këtu tani? - më pyeti Julia. - A nuk duhet të takoheshe me të sot?

- Po, - i thashë, - u takova.

Ajo shtangu. Gjuhën e saj, që s'di të futet në gojë thuajse kurrë, e zuri ngërçi. U krijua një situatë gati paniku mes nesh. Unë nga frika se atëherë e kuptova realisht ç'kisha katranosur dhe ajo ngase ende nuk po kuptonte asgjë.

- Po ç'dreqin ndodhi?

- Dëgjo, Julia, qetësohu. A nuk më ke thënë se asgjë nuk ndodh pa shkak?

- Po, të kam thënë. Po fol, pra, çfarë ka ndodhur?

- Mirë, unë po të them se ç'më ndodhi, ndërsa ti mundohu të gjeshe shkakun. Se ajo që ndodhi, iku, u bë.

- Ja, ta marrim me qetësi. Ikim pimë një kafe te "Gloria", - tha Julia, - dhe atje m'i tregon të gjitha.

- Jooooo, - ulërita unë me sa kisha fuqi zëri në fytyrë. Jo te "Gloria", se atje e lashë atë vetëm dhe ika.



*E pabotuar, fragment nga libri në proces, me katër noveltha*

# GLORIA IN EXCELSIS DEO

Anna Kove



- Si moj ike?

- Po, ika. I lashë të kuptojë se po ulem në tualet. Dhe nuk u ngjita më lart.

- Ç'dreq veprimi është ky?

- Kështu m'u dha të veproj. Vetë më ke thënë se karma është veprim që i referohet një koncepti shpirtëror dhe të ndikon pavetëdijshëm në trup e mendje. Ja ashtu i tha mendja trupit të zhvendoset.

- Mojt, ose ti ose unë jemi të çmendura tani në këto momente.

- Të dyja jemi, Julia. Qysh se nuk dimë të shijojmë më asgjë, pa teorizuar pafund.

- Atëherë eja e më trego... se ketë punë e qan ti, - dhe më kapi për krahu.

Unë nuk dija nga t'ia nisja. Rrezikoja të dukesh krejt qesharake jo vetëm në sytë e saj, por edhe vetes nuk po ia duroja atë ndjesi të çuditshme që më që mbledhur në fytyrë e gati po më mbyste.

- Kisha frikë të rrija, Julia, - i thashë. - Kisha shumë frikë.

Asaj i dolën sytë nga vendi. Sytë e mi ishin tërë tmerr e panik po ashtu.

- Pse, ç'kishte ai për t'u frikësuar?

- Ishte pikërisht ai që kisha pritur. Nuk ndryshonte fare, fare nga modeli, e kupton ti këtë? Ç'mbetej më pas kësaj, po të rrija? E kupton, Julia?! Edhe kur vinin e iknin të tjerë. Këtë prisja...

- E kuptoj, zemër. Dhe mos ma hidh më poshtë kurrë teorinë e karmës e as mos u tall më me mua.

- Ah, të lutem, Julia, mos sërish, se nuk kam nerva të dëgjoj teorizime tani.

- Më dëgjo. Karma jote e solli atë njeri tek ti. Dëshira për t'u dashur fort me një model, që e kishe zgjedhur përpara se ai të vinte. Modeli, me të cilin ti ke bërë dallimin, ekziston, dhe ti tani e di. E pe, e preke, e puthe. Ja ku e gjetëm edhe shkakun e veprimit tënd. Ai është atje, ku e ke lënë vetëm, te "Gloria". Po sytë si i kishte kur të shihete?



- Vërtet do ta dish, Julia? Iu ngjanin syve të ujkut.

Po, po. Sy si të ujkut. Dhe mua m'u kujtua një roman i porsalexuar i Schmitd-it, ku Anna e Brugg-ës u akuzua për herezi, sepse komunikonte çuditshëm me ujkun. Njësoj si ajo Anna e mesjetës isha edhe unë para tij, ambivalente. E adhuroja kafshën e fortë e superiore para meje dhe projektoja njëkohësisht frikëra të shumëllojshme me shpejtësi drite.

- Kushedi s'i mund të ndihet një ujk i dashuruar nga një princeshë, kështu gjithë hire e ngjyra si ti? Më fol edhe pak, - më nxiti Julia...

- Po nuk ka reagime në sytë e ujkut ndaj ngjyrave, o zemër; as nuk i sheh e as i dallon dot bukuritë e tyre. Në këtë sens, unë nuk bëj asnjë dallim nga kopeja e gjahut. Aq më tepër aty, në prarimin e artë dhe tapetet e kuqe të "Glorias". Është i ndjeshëm ndaj lëvizjes, ujkut. Sytë i reagojnë nga lëvizja. Ndaj s'munda të rrija më gjatë pa lëvizur... E kupton tani pse ika?

- Pra ti nuk mendon se do ta humbësh, tani që gjete modelin?

- Ç'dreqin ke që më shikon kështu?! Vetë ma ke ënjtur kokën me ato teoritë e rimishërimit. Do ta kem sërish kur të rimishërohem... Unë kuptova t'i lexoj psherëtimën dhe jo fjalën. Ia lexova atë që mbante brenda fare dhe nuk e tha dot.

- Prandaj shkove në atë takim?

- Po, prandaj shkova. Edhe pse e dija vazhdimin. Shkova të shihja se ç'isha gati të humbisja, pikërisht në më të dashurin vend tonin, te "Gloria".

- Prit radhën tani, - më tha Julia. - Kur t'i shkosh ti, do të ikë ai, - dhe më propozoi gjithsesi të shkonim e ta festonim me ndonjë gotë verë. Ashtu bëmë, ngjitëm shkallët duke qeshur me zë e duke përjetuar aktin e parë të shijimit të lavdisë me përplasjen e takave fort pa shkallëve.

(X2)

Nuk u zgjova atë ditë si zakonisht nga alarmi i regjistruar në telefon. Ishte zgjim i pazakontë. Nga disa tinguj të cilët më depërtuan deri në gjumë; u rrotullova disi nëpër krevat me shpresën se mos vazhdoja edhe pak të flija, por s'munda. Dera e blinduar dhe muret e trasha nuk lejonin asnjë lloj zhurme të futej brenda. Dritaret i kisha mbyllur, grilat po ashtu. Asnjë magnetofon a radio nuk kisha në shtëpi. Televizorin e fika me telekomandë, para se të shtrihesha. Atëherë nga drejtin futeshin deri brenda veshëve këta tinguj? Më dukej se i dëgjoja me gjithë qenien. Se edhe trupi sikur po lëvizte nëpër shtrat, ashtu si në sintoni me to. Nuk doja të zgjohesha aq shpejt. Ishte ditë pushimi.





Disa poezi franceze, sprova rinore të përkthyesit Vedat Kokona në librin "Lule të pavenitura", u botuan për herë të parë më 2006, për të cilat përkthyesi pati thënë: "...atëherë sapo kisha filluar të çapitesha dhe të bridhja në lulishten e poezisë franceze, kur lija mënjane, me gëzim por edhe me pendim, problemet e gjeometrisë apo të fizikës, lodroja lëndinave poetike dhe dehesha me nektarin e vargjeve të Lamartinit, Hygoit e sidomos Mysesë... nuk më shkonte asnjë t'imitë ndër mend se një ditë, buzë mbrënje së pleqërisë, do t'i mblidhja lulet e këputura ende të njoma dhe të pikura me vesën e mëngjesit për t'i bërë një tufë..."

# LULE TË PAVENITURA

Përktheu: Vedat Kokona



## SIDI (fragment)

Pierre Corneille (1606-1684)

### AKTI II, SKENA IV

#### DON DIEGU

O turp! o ditë e zezë! u shofsh, moj pleqëri!  
Gjer sot mos kam jetuar veç për këtë poshtërsi?  
Në fushat e betejës mos vallë unë u thinja  
Të shoh brenda një dite të fishken aq dafina?  
Ky krah, të cilin Spanja sodiste me nderim,  
Ky krah, që sa e sa herë shpëtoi perandorinë,  
Dhe fron'i mbretërisë sa ish ai s'u lua  
Në balt' sot të më lërë e s'bën asgjë për mua?  
Oh, sa më qan kjo zemër për një lavdi të shkuar!  
Veprën e kaqë ditëve një ditë e ka rrënuar!  
Kjo shkallë ku u ngrita ç'ma prishi lumturinë,  
Nga nderi im i shtrenjtë bie si në greminë.  
Atje kur të arrijë un' Kontin ta shikoj  
Të vdes pa marrë gjakun, ose me turp të rroj?  
O Kont, guvernator i princit ji ti sot,  
Se një njeri pa nder kjo gradë s'pranon dot;  
Edhe zilia jote që më varros të gjallë  
Dhe pse mbreti më zgjodhi, më zbret nga ajo shkallë.  
Dhe ti, e trimërive o vegël lavdiplotë,  
Por sot e trupit akull veç një stoli e kotë,  
O shpatë e lemeritshme kur të vërtitja unë,  
Që, kur ma muar nderin s'më hyre aspak në punë,  
Shko, ikë tani shpejt nga kjo dorë e pështire,  
Kalo, për të shpague në dorën më të mirë!

SKENA V - (Don Diego, Don Rodrigue)

#### DON DIEGU

Rodrig, a më je burrë?

#### DON RODRIGU

Veç teje kush të dojë  
Të vijë e ta provojë!

#### DON DIEGU

Të lumtë ajo gojë!  
Por dhembjen s'ma shëron, o bir, ky zemërim!  
Në pezmin tënd fisnik e njoh sot gjakun tim!  
Gjithë rinia ime rilind në këtë flakë,  
Pa eja, bir, pa eja që të shpagosh tët atë,  
Pa eja ma laj turpin.

#### DON RODRIGU

Çfarë turp?

#### DON DIEGU

Shuplakë e shkretë

Sot nderin e shtëpisë na nxin, o bir, përjetë:  
Atë që pat guximën s'e lija, besa, gjallë,  
Por pleqëri e zezë nuk mundi t'i bëj ballë!  
Dhe shpatën që kjo dorë e zonja s'është ta mbajë  
Ja ku ta jap, o bir, që turpin të na lajë!  
Më një kapadai shko të luftosh ti fill,  
Se vetëm gjaku e lan një poshtërim të tillë.  
Vra, o vdis. Por ki mendjen, mos u hidh me rrëmbim:  
Armiku që të jap, ta dish, është burrë trim;  
Gjithë gjak e gjithë pluhur me sytë e mi e kam parë  
Kur kallte lemerinë ndër mijëra ushtarë;  
Kam parë si vërsulej e hidhej drejt në sulm,  
Edhe ta dish, jo veç që është luftar plot zulmë,  
Jo veç një trim i madh në fushat e betejës, Por është!...



## NË SHPIRT KAM NJË TË FSHEHTË


Feux Arvers (1806-1850)

Në shpirt kam një të fshehtë dhe një mister në jetë;  
Një dashuri e zjarrt' në çast m'u ndez në gji;  
Brenga s'më ka shërim, andaj e mbaj të fshehtë,  
Edhe ajo që e ndezi misterin nuk ma di.

Oji! Posi një hije nga pas un do t'i rri,  
Ngaherë pranë saj, por prapë fill i vetë,  
Gjersa një ditë sytë un' do t'i mbyll përjetë  
Pa thënë gjysmë fjalë nga gjithë kjo dashuri.

Ajo, që Zoti e bëri të butëzë si shtjerrë,  
Udhës do të kalojë pa vënë re, pa ndjerë,  
Se ne çdo hap të saj ky shpirt do psherëtijë.

Besnike ndaj kurorës, e pastër, e kulluar,  
Do thotë këta vargje pasi t'i ketë kënduar:  
"Cila të jet' kjo grua?" dhe kurrë s'do ta dijë!



## FEDRA (fragment)

Jean Racine (1639-1699)

### AKTI I, SKENA III (Fedra, Enona)

#### FEDRA

Rrënjët më thellë, Enonë, i ka kjo brengë e shkretë.  
Me djalin e Egjeut sa lidhur qesh' përjetë,  
E lumtur dhe e qetë kujtoja do jetoj;  
Armikun tim krenar Athina ma tregoi.  
E pashë, u skuqa, u zbeva, mbeta si e zalisur,  
Si valë u ngrit hutimi në shpirtin e trallisur;  
M'u errën sytë e ballit dhe goja m'u nemit,  
Akull m'u bë gjith' trupit, njëherësh m'u zhurit.  
E njoha Afërditën dhe zjarrin shkatërrimtar  
Në gjak që më kish ndezur shpagimin për të marrë.  
Në lutje të paprera kërkoja ngushëllim.  
Një tempull i ndërtova, e stolisa me durim;  
Ngahera me viktima siç isha e rrethuar  
N'gjithë e tyre kërkoja mendjen time t'hutuar;  
Por zjarri i dashurisë po digjej si më parë.  
Më kot dogja, e mjera, temjanin mbi altarë:  
Kur emrin e Hyjneshës shqiptonte zëri im  
Un doja Hipolitin; e shihja pa pushim  
Atje, afër altarit, dhe zotit që s'guxoja  
Emrin që t'ia përmend të gjitha i blatoja.  
Nuk doja që ta shihja fytyrën që më vret,  
Por sytë e mi e shihnin tek tiparet e t'et.  
Ahere zjarrin tim un' desha që ta shuaj:  
Armikun që e doja e bëra që të vuaj;  
Atë që e adhuroja kërkoja ta mërgoj,  
Posi një njerë e keqe veprova kësioj:  
Mërgimin e tij e desha, britmat e mia u shtuan  
Dhe nga krahët e t'et të birin e larguan.  
U lehtësova, Enonë, dhe me ikjen e tij  
Nisa t'i shijoj prapë ditët në qetësi.  
E mbyta brengën time, martesës iu nënshtrova  
Edhe atë që doja që ta martoj kërkoja.  
O ç'fat i zi! Të kota të gjitha masat qenë!  
Im shoq një ditë e solli të birin në Trezenë,  
E pashë prapë armikun q'e kisha nisur lark  
Dhe plaga e pezmatuar filloi të rrjedhë gjak;  
Dhe zjarri i dashurisë, në rrembat i tulitur,  
Gjith' trupin e dërrmuar tani ma ka zhuritur.  
Për krimin tim, Enonë, kam marrë lemerinë,  
Sot jetën e urrej, urrej dhe dashurinë.  
Me vdekjen doja nderin ta mbaj të pacenuar,  
Një dashuri e turpshme të mbetej pa zbuluar;  
Por lotët që ti derdhje nuk munda t'i duroj;  
Të thashë të vërtetën dhe bëra mirë, besoj.  
Veç dije, Enonë e dashur, se vdekja më afrohet;  
Mos më qorto që shpirti më shumë të dëshpërohet,  
Dhe kot mos u munda të lidhësh me kujdes  
Fillin e jetës sime që m'u këput në mes.



## RRI URTË O BRENGA IME

Charles Baudelaire (1821-1867)

Rri urtë o Brenga ime dhe falmë qetësinë;  
Ti mbrëmjen e kërkoje, ja tek po zbret tani;  
Pëlhurën mbi qytet të mugëtit po e shtrin,  
Disave u sjell paqe, të tjerëve mëzri.

Kur turma e ndyrë e njerëzve, që veç dëfrime dinë,  
Të fshikur nga kamxhiku i Epshit në gosti  
Të poshtëz zhgryhen krejt ndërsa pendime u vijnë,  
O Brengë, nëma dorën, me mua eja e rri.

Larg tyre. Shih si kërrusen gjith' vjetët e harruar,  
Lart nga ballkoni i qiellit me petka të vjetruar,  
Si ngrihet Mall'i hidhur nga ujjat buzëgaz;

Nën urë Diell i mekur si bje kur vjen ndajnata  
Dhe, si qefin në Lindje, nga hijet ndjekur pas,  
Dëgjo, dëgjo, e dashur, si ecë e ëmbël Nata.



# NELO LLUKAÇI DHE “EKSPOZITA E UNIT”

Bledar Kurti

Skulptori i njohur Nelo Llukaçi ka zgjedhur një titull S të veçantë për ekspozitën e tij, “Nelo – Ekspozita e Unit”, e cila do të qëndrojë e hapur gjatë datave 5-30 korrik në Galerinë e Arteve Figurative “Nikolet Vasia” në Durrës.

Nelo lindi më 17 gusht 1938, në një familje punëtore me baba podgorican (profesion marinar) dhe nënë italiane (shtëpiake tejet e apasionuar pas artit). Djali i fundit i 7 fëmijëve ishte i vetmi që zhvilloi talentin e tij i ndikuar nga nëna, Leopoldina, e cila i fliste për artin (operën të cilën e kishte parë dhe dëgjuar në teatrin “Giuseppe Verdi” në Fiume) dhe vëllai tij Dario që më vonë do të ishte një aktor i njohur i humorit.

Që në hapat e parë me vizatimet e tij tërhoqi vëmendjen në shkollë të profesor Sabri Tuçit, figurë e shquar e artit shqiptar, i shkolluar në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë, Itali. Pasi dallooi talentin e tij, profesor Sabriu e afroi në studion e tij, ku zhvillonte kursin e vizatimit për Shtëpinë e Pionierit. Nelo, i dhënë pas artit dhe i etur për krijimtari, e ktheu në qëllim të jetës së tij artin figurativ. Kështu filloi aktiviteti artistik i tij me vepra të shumta që pasuan njëra-tjetrën. Ta dëgjosh, edhe sot e kësaj dite ai flet me një pasion e dashuri të madhe për artin dhe për atë çfarë arti përfaqëson. Ai jeton me të, flet me të dhe lexon atë, e ndien në çdo frymë dhe në çdo sekondë të jetës sonë të përditshme.

Krijimtaria e tij është e larmishme, që nga vizatimet e para, pikturat dhe skulpturat e para, duke arritur në ditët e sotme me ndërthurjen e materialeve të ndryshme; kjo shihet jo vetëm në vepër, por edhe në mënyrën si ta shpjegon ai dhe e brendshmja e tij. Hyjmë në studion e tij, shohim vepra nga fillimet e tij e deri sot, dhe vërejmë një mozaik veprash që të gjitha së bashku krijojnë një njeri, formojnë Nelon. Artistin e përmbushur. Artin në plotësinë e vet.

Gdhendje pafund në krijimtarinë e tij për t’i bërë idetë të përjetshme. Vepra në allçi të tornuar, në bakër, qeramikë, plumb eksperimentues, i përjetshëm me thjeshtësinë e tij.

“Vallja e çlirimit” – një “remake” në gur i origjinalit që ndodhet në Galerinë Kombëtare të Arteve, fituese në vitin 1971, ekspozuar ndërkombëtarisht; “Luli i vocërr” – një tjetër vepër autentike bazuar në vargjet e të madhit Migjen; “Mundësitë”, “Elektrifikimi”, “Mendimi i përbashkët teknik”, “Me këngë në gojë”, “U kthesh me fitore”, “1 Qershori” “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, “Luigj Gurakuqi e Ded Gjon Luli” e shumë portrete e kompozime të tjera.

Përveç skulpturës, Nelo ka pikturuar gjithmonë në mënyrë të natyrshme plot emocion vepra të ndryshme, sidomos lulet janë pasioni i tij. Tregon gjithmonë për lulet e Muzeut Arkeologjik që e kanë emocionuar me bukurinë e tyre gjatë veprimtarisë së tij si restaurator



“

**“Vallja e çlirimit” – një “remake” në gur i origjinalit që ndodhet në Galerinë Kombëtare të Arteve, fituese në vitin 1971, ekspozuar ndërkombëtarisht; “Luli i vocërr” – një tjetër vepër autentike bazuar në vargjet e të madhit Migjen**

i objekteve arkeologjike. Një jetë mes skulpturës, pikturës, restaurimit plot emocione, formash e ngjyrash. E gjitha kjo përmbledhet në një ekspozitë të vetme, e cila ngjason me një vizitë në studion e artistit dhe një udhëtim në botën e vetë artistit.

Gjen emocionet e Nelos në kapakët e salcës së dikurshme, në portrete të incizuara me mjeshtëri, derdhjet në metal, një pasion tjetër i tij. Çdo ditë është një ngacim e shtysë për të, jeton me format dhe gjetjet në natyrë ndër vite. Ai shprehet: “Çdo gjë ekziston në natyrë, ne kemi vetëm aftësinë ta evidentojmë me të brendshmen tonë.”

“Shpirtra që kërkojnë liri”, “Viktima të eksodit”, “Në udhëkryqet e Europës”, “Britma” janë disa nga veprat e pas 90-tës me gjendje shpirtërore e artistike të ndryshimit që ndodhi. “Poezia, drama, tragjedia e mendimit njerëzor” në tel bakri, një filozofi jete.

“Ditët që jetojmë” – një vepër unike në konceptimin e saj që i përket së shkuarës, së sotmes dhe së ardhmes. Bie menjëherë në sy një vepër në qeramikë “Pro dhe kundër vetes”. I pyetur mbi të, me thjeshtësinë e tij, përgjigjet: “Herë pajtohem me veten e herë jo, ne jemi gjithmonë në kërkim të gjetjes.” Ky është Nelo, gjithmonë në kërkim e në provë me aftësitë e veta për të krijuar me unin e tij. Kjo ekspozitë është një ftesë në studion e tij, por, përtej kësaj, është një udhëtim në botën e vetë artistit.



# JUAN RODOLFO WILCOCK

## SINAGOGA E IKONATHYESVE

Arben Dedja

Më 4 prill 1979 shkrimtarit Juan Rodolfo Wilcock, li lindur në Buenos Aries më 17 prill 1919, baba anglez, nënë argjentinase (me origjinë piemonteze), iu dha shtetësia italiane. E kish dorëzuar kërkesën për të marrë shtetësinë e vendit ku jetonte prej 20 vitesh (ai – oriund) dhe ku kish botuar mbi 20 libra, qysh në vitin 1975, derisa më në fund, mbas katër vjetësh – vonesë fiziologjike e burokracisë italiane – përgjigja pozitive, akti i firmosur nga Presidenti i Republikës, erdhi.


E kërkuar adresave që kish lënë: në periferinë e Romës, me shtëpi përdhese, oborre mbuluar nga shkurret dhe mure leskra-leskra e tërë igrasi, në Velletri – vendbanimi i lashtë i volshëve, pastaj në Lubriano, qytezë etruske e baroke me më pak se 1000 banorë ku, për t'i ikur rrumpallës së kryeqytetit, u tha se ish transferuar, në një shtëpi në krah të varrezave, me përballë pamjen mahnitëse të majave të kodrinave prej shtufi, tekta qielli zbret mbi lugjinë e Kalankeve. Nuk e gjetën dot. Sepse Juan Rodolfo Wilcock ndërkaq kish një vit i vdekur (16 mars 1978), pikërisht në ditën kur Brigadat e Kuqe patën rrëmbyer Aldo Moron (me Italinë të hutuar, që të mund t'i kushtonte një pikë vëmendjeje këtij shkrimtari të çuditshëm). Kështu, me këtë absurd të vdekjes kur s'duhej dhe të shtetësisë pas të vjelave, mbyllet aventura tokësore e Wilcock-ut.

Kish banuar në periferinë më të varfër të Buenos Ariesit; i ati ishte punëtor, e ëma shtëpiake, ai triling. Vetëm lexonte. Nuk u mjaftua me gjuhët që dinte, mësoi edhe frëngjishten e gjermanishten. T'i mësonte, për Wilcock-un desh të thosh t'i sundonte (ende adoleshent, përktheu në spanjisht "Ditarët" e Kafka-s, një përvojë që e shenjoi). Desh gjithashtu të thosh, për të, ta lexonte letërsinë vetëm në origjinal. Ka mjekë që nuk kanë shumë besim te mjekësia kur vjen puna për veten e tyre. Në të njëjtën linjë mendimi, Wilcock-u, vetë një përkthyes nga më virtuozet, nuk lexonte libra po të mos qenë në gjuhën origjinale (kështu, për shembull, gjatë jetës së tij, nuk lexoi kurrë letërsi ruse). Regjistrohet në Fakultetin e Inxhinierisë të Universitetit të Buenos Ariesit: studionte, punonte si punëtor krahu, jepte provimet.

Bëhet rastësisht shkrimtar, kur zhvillon atë ndjenjë dhe besim të të gjithë njerëzve të ndrojtur, por të talentuar, që gjërat mund të përmirësohen, në këtë rast letërsia e kohës (ajo midis dy luftërave botërore): ai dinte ta shkruante më mirë. Ndaj u ul, pra, të shkruajë një libër (vëllimin me poezi: *Libro de Poemas y canciones*, 1940); iu desh një muaj, ishte verë, kohë provimesh bashkë e pushimesh. Libri bëri bujë, fitoi Çmimin "Martín Fierro", vitin pasardhës Çmimin "Qyteti i Buenos Ariesit", me vlera monetare që e lejuan të heqë dorë nga puna e krahut dhe të diplomohet më shpejt si inxhinier (1943). Fillon punë në Hekurudhat Shtetërore, por nuk zgjat shumë, një vit e veç kur jep dorëheqjen (1944). Nis të merret gjithnjë e më seriozisht, obsesivisht, me letërsi. Vetëm në vitet '40 boton edhe pesë libra të tjerë poetikë, merret, sakaq, me gazetari dhe, në disa nga revistat argjentinase më të rëndësishme të kohës (ndonjë e drejton edhe vetë: *Verde Memoria* 1942-44; *Disco* 1945-47 etj.), boton kritikë letrare, ese, kritikë arti, drama [më vonë doli që një pjesë e këtyre kritikave ishin mbi libra të rremë, të pabotuar kurrë – pjellë e fantazisë –; apo recensione ekspozitash inekzistente (ku "paraqisnin" punët e tyre piktorë e skulptorë kallpë), bile edhe shumë pjesë teatrale ishin të shpikura dhe regjisorët/aktorët irrealë (shihni kapitullin mbi regjisorin Llorenz Riber,

në librin që keni në duar)]. Një redaksitë e revistave letrare njej dhe zë mik Borges-in, Silvina Ocampo-n, Adolfo Bioy Casares-in. Me çiftin Ocampo-Casares, më 1951 ndërmerr udhëtimin e tij të parë në Europën e pasluftës: viziton Londrën, Romën, Parisin, Zvicrën ku ka varret e gjyshërve. Tani që erdhi në Europë qëndron aty gjatë (për një vit, 1953-54, në Londër është përkthyes dhe bashkëpunëtor i BBC-së). Kur kthehet në Argjentinë ndjen që erërat kanë ndryshuar, një klimë e acartë diktaturash po e ndërthun Amerikën Latine.

Kështu, në verën e vitit 1955, merr anijen që do ta çojë për fare në Europë. Zgjedh Italinë; vendoset fillimisht në Romë, periferive; si në çdo periferi shtëpia e tij ka qen, mace dhe pleshta. Aty lidh miqësi me shkrimtarë dhe njerëz të letrave: Alberto Moravia, Ennio Flaiano, Elsa Morante, Luciano Foà, Pier Paolo Pasolini, Roberto Calasso... Miqësitë janë kryesisht të majta, ndërkohë bashkëpunon me faqen kulturore të një gazete të djathtë ("Il Tempo"). Pasolini e angazhon si aktor në filmin e tij "Ungjilli sipas Mateut" (1964), ku, pavarësisht syve të kaltër dhe hundës së hollë, luan rolin e kryepriutit Kajfa (e si mund të ndodhte ndryshe: ai – aq mendjemprehtë, ironik, me atë buzëqeshje prej kufome); boton fantashkencë; përkthen letërsi latino-amerikane; përkthen (nga anglishtja në italisht) një kondensat të veprës më të papërkthyeshme, "Finnegans Wake", e ri-rrëfen këtë ëndërr të Joyce-it ai, si irlandezi i famshëm pluriling i dashuruar me Italinë, me fragmentin më të gjatë dhënë gjer sot në italisht (ende "Finnegans Wake" mungon i plotë në Itali); fillon edhe vetë t'i shkruajë drejtpërsëdrejti në italisht veprat e veta, dhe nuk janë pak: romane, poezi, komedi, tregime dhe, sidomos proza, është e vështirë të kategorizohet në gjini të mirëfillta. Fragmenti, shkollitja e tematikave, luhata e stilit, mizoria e vështrimit të autorit, gjithnjë tragjik dhe dëfrimtar, një shije e hollë për të ndjellë llahtarën dhe bukurinë e saj të nëndheshme, që askush tjetër nuk i avitet, janë disa nga karakteristikat e kësaj veprë.



Libri që keni sot në duar, është ndoshta nga më tipikët, padyshim ndër më të lumturit që ka dalë nga pena e Wilcock-ut. Kur Ataol Kaso ma propozoi, në një nga ato vizitat e mia tokatë e fugë në vendlindje, nuk mund të them se e prita me entuziazëm ftesën. Deri atëhere kisha përkthyer gati ekskluzivisht poezi, pesë libra poetikë tejet heterogjenë në shije dhe në përkatësinë e autorëve të tyre kishin parë dritën e botimit (jeta ecën: të tjerë kanë pasuar); proza, kjo dashuri e vonë, hezitonte t'ia hapte udhën vetes. Por, nga ana tjetër, e di mirë që ajo ç'ka ma mban gjallë shqipen, më shumë se të shkruarit në shqip është përkthimi në shqip, për arsye se kam kështu shkasin të lexoj fjalorët. Leximi i fjalorit. Ngjan si oksimoron: e si mund të lexohet fjalori, ndonjëse përpjekje për t'ia arritur kësaj, për ta bërë fjalorin të pëlqyeshëm për t'u lexuar si një roman të verdhë, edhe janë bërë (shihni, jo më larg, por te ky libër, "përpjekjen" e admirueshme që bën në këtë drejtim, njëri nga personazhet e rëfyer, Jules Flamart).

"Hm, *La sinagoga degli iconoclasti*, e kam lexuar posi", i thashë.

"Për mënyrën se si shkruan, them se të shkon", Ataoli nuk foli më tepër, por, duke e njohur, e kish kaluar me kohë sasinë mesatare të fjalëve të shqiptuara në një bisedë.

Janë 35 rrëfime (titulli i secilit syresh është një emër dhe mbiemër, për ne i padëgjuar), 35 biografi personazhesh të pagjasë, të gjithë ekscentrikë, ndonjëherë makabër, pak groteskë, rrallë të mençur: kryesisht "shkencëtarë" (por jo vetëm të tillë), qëmtuar në 200 vjet histori (nga gjysma e dytë e shekullit XVIII te gjysma e parë e shekullit XX); ca realë, ca kryekëput të shpikur, dhe shënimi i shkurtër që autori vë në fund të librit i ngatërron edhe më keq punët. Po cilët janë këta personazhe? Ja një *incipit*:

*Lexime kuturu dhe një besim i tepër e kandisën pastorin ungjillor Gheorghescu të ruante në kripë një sasi të pazakontë zezakësh moshash të ndryshme: llogaritet që nëpër vaskat e gjera e të thella të fazenda-s së tij O Paraiso, ngjitur me kriporen e braktisur të Ambao-s në rrethinat e Belem-it, të shtetit Pará, të jenë gjetur 227 kufoma në stade të ndryshme kalbëzimi, të gjitha të orientuara kah drejtimi (i pandehur) i Jeruzalemit në Palestinë, gjithsecili me nga një havengë, edhe ajo e kripur, ndër dhembë. (Theodor Gheorghescu).*

Kështu janë këta të gjithë: Aaron Rosenblum – një utopik, që rreket ta kthejë rrotën e historisë prapa, pikërisht në kohën e mbretëreshës Elizabetë; Aram Kugiungian – me shpirtin që i shtegton në dhjetëra, qindra njerëz të tjerë; Roger Babson – një milioner, që investon miliona dollarë për të zbuluar një lidhje metalesh që izolon forcën e rëndesës; Absalon Amet – orëndreqës dhe shpikës i makinës "Filozofi Universal"; Carlo Olgiati – autor i veprës së shkalluar *Metabolizmi historik*; Franz Piet Vredjuik – mbron, në një libër edhe ky, teorinë që zëri është tjetër pos dritë e zvetënuar; Henrik Lorgion, mjek – është kërkuesi i një lënde shëtitëse të quajtur "eumorfinë", që davaritet kur jeta vdes; André Lebran-i – është shpikësi i pesëçikletës; belgu Henry Bucher – e detyron kohën të rrjedhë më ngadalë; Yves de Lalande-i – është pronar i një fabrike që prodhon romane (672 romane në 15 vjet); Philip Baumberg – vë në funksionim për herë të parë pompën e tij me qen (*dog-pump*); Jesús Pica Planas – shpikës qindra mekanizmash, mjetesh e sistemesh nga më të çuditshmet (dhe të kotat); etj., etj. Ky libër argëtues, në pamje të parë jo i vështirë për t'u përkthyer edhe ngaqë botuesit patën mirësinë dhe durimin të më jepnin një kohë të gjatë për ta punuar (që të nxinte brenda dilatacionet dhe divagacionet e mia), nuk qe pastaj, një kafshatë aq e lehtë. Italishtja e Wilcock-ut është trillane, e sforcon sintaksën e kësaj gjuhe që, gjithsesi, autori e ka mësuar në Argjentinë, aq sa nganjëherë fraza ngjan gabim; shenjat e pikësimit i përdor në mënyrë të përhënur, duke e ngatërruar edhe më fjalinë. Në shqip frazat i kam lënë ashtu, por nganjëherë, ama, edhe i kam ndrequr (nuk dua të marr damkën e atij që e ka harruar shqipen!). Shpesh në tekst flitet për gjëra teknike: atëhere jam përpjekur të përdor terma "puristë"; kjo nganjëherë i jep një ndjenjë të huajsimi tekstit shqip, që them shkon për bukuri, meqë kemi të bëjmë gjithmonë me personazhe të fandaksur. Për përkthimin nuk kam ç'të shtoj tjetër. Autorit, që fati e deshi të jem i pari që ua ndej shqiptarëve, i uroj, jo si ajo puna e shtetësisë një shugurim të vonë, por një mirëseardhje dashamirë mes një populli po aq të çuditshëm.



# AT FABIAN BARKATA

## DITARI I PANJOHUR SHQIPTAR, NGA NJË FRANÇESKAN AUSTRIAK

nga Ndue Dedaj

Fabian Barcatta (Barkata) (1868-1954) misionar françeskan austriak, shkrimtar, piktor, dijetar, ka shërbyer në Shqipëri (kryesisht në Rubik, por dhe në Shkodër e Lezhë) për dhjetë vjet, dy herë, nga viti 1895 - 1897 dhe 1899 - 1907. Në fillimet e karrierës, në vitet 1893-189 kishite shërbyer si lektor i klerikëve shqiptarë në Graz. Pas largimit nga Shqipëria, për në Austri, më 1907, për shkak se u sëmur nga malaria, shërbeu në manastiret françeskane: Kaltern, Bozen, Vallach, Schwaz, St. Martin etj. Autori i romanit të mirënjohur "Lule" (botuar për herë të parë në gjermanisht, Mynih 1924; shtëpia botuese "Tyrolia", Innsbruck, 1929; shqip nga "Nikaj" 1930, përkthyer nga prof. Karl Gurakuqi) si dhe i disa *novelave e historive* kushtuar shqiptarëve. "Ditari im shqiptar" i Barcatës, përkthyer nga **Angjelina Leka**, botohet për herë të parë në shqip, nga shtëpia botuese "Mirdita", në njëqindvjetorin e tij, në vitin 2005. Ai u shkrua në vitin 1905-1906 në Kryezez (Rubik) dhe u botua njëzet vjet më vonë në revistën françeskane *Französischglöcklein* Austri, në vitet 1926-1927. Sa dimë, është i pari ditar i mirëfilltë i një të huaji për Shqipërinë. Janë përmendur dhe dy vepra të tjera, të panjohura të Fabian Barcatës, "Gjaku i falun" dhe "Kumbona e thyeme". Kohët e fundit, studiuesi i nderuar Dr. Michael Schmidt-Neke, kryetar i shoqatës së miqësisë Gjermani - Shqipëri, ka pasur mirësinë të na shkruante, se vitin e kaluar ai kishte "blerë tiposkriptin e romanit "Geschenktes Blut. Vätersatzung und Väterbrauch in den albanischen Bergen" ("Gjaku i falun. Doket dhe zakonet e të parëve"), që ishte shitur si variant i parë i "Lules", e cila mban të njëjtin nëntitull... Ky zbulim është një lajm i mirë, pasi një ditë mund të arrihet botimi në shqip dhe i kësaj novele, ndërkohë që për veprën tjetër "Kumbona e thyeme", ende nuk dihet asgjë.

\*\*\*

Ditari Shqiptar i Fabian Barcatës ka qenë i panjohur për lexuesin shqiptar. Botimi i tij në shqip u mundësua pas njëqind vjetësh nga koha kur u shkrua. Përshkrimi me detaje i njerëzve, i varfërisë, sëmundjeve, bestytive, por dhe i karakterit dhe virtyteve të tyre përbëjnë lëndën e tij origjinale. Hyn në radhën e librave dhe shkrimeve të të huajve që e pasurojnë njohjen mbi botën shqiptare. Ditari paraqet vlerë të posaçme pse u shkrua nga një i huaj, që nuk e sodit por e përjeton botën shqiptare, jo vetëm e prek atë, por dhe *preket* prej saj. Është një dëshmi që nuk buron thjesht nga njohja e sipërfaqshme, me përshkrime të tipit "Si e pashë unë Shqipërinë", por dhe nga humanizmi, dashuria për të. Dhënia e disa ndodhivë hap pas hapi ka bërë që *Ditari* në tërësi të jetë si një roman, ngaqë "personazhet" e tij shpesh të shoqërojnë për një kohë të gjatë, ku tipike është gruaja e sëmurë epileptike Dilë, që arrin të shërohet si me profeci falë ndihmës së frarit dijetar. Në "*Ditari im shqiptar*" autori shfaqet vezhgues i drejtpërdrejtë, përjetues i thellë, interpret i veçanësive njerëzore, ku pamja e mjerimit dhe i mbijetesës është mbizotëruese. Ashtu si te romani i mirënjohur "Lule", ai shfaqet jo si një kronist i thjeshtë i ngjarjeve dhe rrethanave, por si një shkrimtar, që din me mjeshtri të përdorë rrëfimin, përshkrimin, detajin, portretin, *peizazhin*, herë duke u frymëzuar nga bota e fëmijëve, herë nga notat intime të vendlindjes së munguar, Tirolit. Bie në sy stili rrëfimtari, konciz, ku disa nga episodet ngjajnë si skica dhe tregimthe të mirëfillta realiste, si "Një shpirt i ndjeshëm dhe besimtar", me elemente befasese: njeriu që e pret vdekjen duke e parë në sy, i cili cek në bisedën e fundit me fratin vetëm "mekatet", anët negative të jetës së vet. Sapo mbaron këtë lloj rrëfimi të çuditshëm, ai shtrihet



dhe vdes qetësisht, sikur ta kishte thirrur ai vdekjen e tij atë çast dhe jo si ta kishte në dorë vdekja atë. Merita e autorit qendron në sjelljen e këtij lloji tipi *sui generis* mirditasi, i denjë për sfondin klasik të teatrit shekspirian. "Pasi folem rreth një gjysëm ore me njëri-tjetrin, ai hoqi cigaren nga goja, u shtri në tokë, më mori dorën dhe pas disa frymëmarrjeve të zgjatura, vdiq", përmbyll autori historinë e rrëfyer. Ditari e shpie lexuesin nëpër një relief jetësor përgjithësisht të trishtë, gjithë ndodhi dhe bestytini, duke e njohur me njerëz të varfër, të sëmurë, që nuk e kanë bjerrur shpresën dhe kuptimin e jetës. Ngjan si një "regjistër" ku noterizohet gjithçka që përben jetën e Kryezezit në zgrip, ku ka vdekje të shpeshta dhe kërcënojnë epidemitë. Shumica e njerëzve vdisnin nga mungesa e mjekut, ilaçeve dhe kujdesit shëndetësor, ku priftit, të gjendur si në rrethim nga një situatë e tillë, i duhej të jepte zgjidhje për gjithçka, sa ai të befason kur thotë se në dhomën e të vdekurit mora vendimin për t'u bërë vetë mjek. Për të nuk është e huaj asgjë që lidhet me fatin e famullisë së tij. Shpesh fretërit, murgeshat bënin dhe punën e mjekut dhe infermierit, si murgeshat e Kallmetit asokohe, gjithashtu austriake. Kjo të sjell ndërmend shembullin e papërsëritshëm të *fratit të pashallarëve të Shkodrës*, At Erasmo Balneo-s, portretizuar me aq mjeshtri nga At Zef Pllumi. Në fletën e ditarit të Barcatës të 21 gushtit 1905, zhvillohet një dialog nga më të pabesueshmit, mes fratit dhe një të sapovrari, në agoninë e fundit. Prifti e fundit Ndrekën "A do ta falësh vrasësin tënd?" dhe ai i përgjigjet si një i krishterë i devotshëm: "Oh, me gjithë zemër". Një ndodhi gjakmarrjeje, e përshkruar me ndjesinë e njeriut të fesë, si një rrëfim artistik, ku syrit dhe lapsit të autorit nuk i shpëton asnjë detaj, por "pikturon" dhe fytyrat e dy bijave të vogla të të vrrarit, "që të pikëlluara nga dhimbja qendronin të heshtura pranë të atit me një perkushtim absolut." Në Ditarin e Barcatës lëviz një gjindje e lodhur, e sëmurë, e varfër dhe pa vese, pleq, fëmijë, gra, supersticiozë, bestytë, ku ai shfaqet i vendosur dhe veprues në luftimin e bestytive. Për Gjoka, njëri nga rubikasit e vjetër, e ka kapur sensin e ndryshim, të perspektivës, ndaj arsimimit e të birin e argumenton kështu: "Jam i bindur që pushtimi nga Turqit nuk do të zgjasë shumë. Pastaj do fillojë një etapë e re, ku të qenurit i aftë, do të vlerësohet më shumë se sot."

Edhe më shumë të shtohet






admirimi për këtë misionar shembull përsëritërie kur mendon se ai i shkroi rreshtat e ditarit të tij shqiptar duke vuajtur dhe vetë nga ethet e malarjes, me duart që i dridheshin. Ashtu si Migjeni ynë, tridhjetë vjet më vonë, që do t'i përcillte malsorët përmes *këngës së dhimbës krenare*, duke qenë dhe ai i kërcënuar nga një sëmundje, shumë më e pabesë se malaria e Barcatës, ku sëmundja e mushkërive atë e këputi në moshën 27 vjeçarë, këtë apostull plak nuk e ndali dot në 86 vitet e jetës së tij prej bohemi.

**Shënimi i redaksisë së revistës *Franziszglöcklein* me rastin e fillimit të botimit të "Ditari im Shqiptar", 1926-27:** Pader Fabiani ka dhënë kontributin e tij me mish e shpirt për popullsinë malore në Shqipëri. Ato çfarë shkruhen në këtë ditar janë përshtypjet e tij origjinale të pandikuara, pasi ai nuk ka menduar asnjëherë që këto fletë një ditë do të botoheshin. Kemi arritur ta botojmë këtë ditar vetëm pas lutjeve të vazhdueshme. Ai do të kishte dashur të ndryshonte diçka, por duke qenë se tani jeton larg, në Amerikë, pranë vëllezërve të tij si artist dhe ndihmon në dekorimin e kishave, besoj se ka ardhur momenti të botojmë këtë libër. Ato vazhdojnë më poshtë dhe janë në formë origjinale, pasi nuk dëshmojnë vetëm aftësitë e tij të pakundërshtueshme si artist dhe shkrimtar, por edhe një shpirt të shenjtë plot dashuri dhe përkujdesje... "Ditari" fatkeqësisht ndërpritet, por thjesht leximi i disa fletoreve të tija do të na sjellë kenaqësi.

**Përcjellje e botimit në gjuhën shqipe të "Ditari im Shqiptar" të Fabian Barcatës, Tiranë 2005.**

Gjasat janë që revista e mirënjohur *Franziszglöcklein* të jetë nxitur për botimin e Ditarit nga sukcesi i botimit gjermanisht të romanit "Lule" të këtij autori në vitin 1924, pasi botimi i tij fillon vetëm dy vjet më vonë, dhe plot njëzet vjet pasi ishte shkruar. Por shënimi i redaksisë së revistës, nuk qartëson gjithçka mbi dorëshkrimin. Thuhet "kemi arritur ta botojmë këtë ditar vetëm pas lutjeve të vazhdueshme", "pasi ai (autori) nuk ka menduar asnjëherë që këto fletë një ditë do të botoheshin", çka nënkupton se ai e kishte shkruar atë ditar për të mos e publikuar. I nxitur nga revista, duket se At Fabiani më në fund kishte qënë dakort dhe kishte përgatitur dhe fotografitë për botimin si libër më vete të ditarit. Megjithatë, Ditari, nuk botohet si libër, por vetëm disa fragmente në faqet e revistës. Ndoshta ngaqë Ditari nuk ishte një vepër e plotë. Në këto kushte, u gjykua që ky ditar në shqip të publikohet në përbërje të një monografie kushtuar Fabian Barcatës, ku veç të tjerash, nga ana jonë janë bërë përpjekje për të sjellë të dhëna biografike të panjohura për autorin dhe veprën e tij.



## PJESË NGA DITARI IM SHQIPTAR I FABIAN BARCATËS

Në Kryezez, për t'u shëruar nga ethet e malarjes  
30 prill 1905

Sot jam kthyer me gjithë çfarë kisha nga Alessio (Lezha). Ethet e malarjes më kishin lodhur shumë kohët e fundit. Gjatë rrugës m'u desh të ndalesha dhe të pushoja dy herë dhe kur arrita këtu dridhsha aq shumë, saqë nuk e kontrolloja dot veten. Pritje festive! Nga lart ku ndodhej kisha dhe famullia, dëgjoheshin të shtenat me pushkë. Ndërmjet të shtenave dëgjohej dhe zëri i ëmbël i këmbanave të kishës. Të gjithë njerëzit që takoja gjatë rrugës më pershendetnin me respekt. Para dyerve të shtëpive dhe kasolleve qendronin grate, ndërsa para tyre vraponin fëmijët disi të trembur, që më vrojtonin me gisht në gojë. Një grua e re me një fëmijë në krah, e cila gjatë rrugës qëndronte pranë meje, me tha me zë të lartë: "Zotëri rri te ne, ajri i Kryezezit do t'ua largojë ethet e sëmundjes". Edhe unë e besoja këtë. Arqipeshkvi më kishte dërguar këtu për t'u shëruar.

5 maj 1905

Dje u ankova për kushtet në banesën time dhe kjo nuk është aspak e drejtë, pasi Zoti nuk ka falur në Kryezez diçka më të mirë. Sa e varfër është kisha këtu! Katër mure të vjetra dhe mbi to një çati e keqe e papërfunduar me pllaka guri dhe përveç kësaj mungon dhe tavani. Altari është si një kub muri, ku për të hipur tek ai, duhet të kalosh mbi dy shkallë, të murosura dhe këto. Mbi altar në mur është varur një pamje e mjerë, e pikturuar në dru. Ka vetëm dy mbajtëse qirinsh prej druri të cilave u mungojnë dhe këmbët. Në vend të këmbëve i kanë vënë gozhdë për t'i mbajtur. Qirinjtë e tjerë mbahen në shishe boshe. Të vetmet stoli në kishë janë dy tufa të vjetra me lule letre, të cilat dhe këto kanë humbur formën e tyre. Si mbajtëse vere shërbejnë dy shishe të vogla të bëra nga kungulli. Kur po thoja për herë të parë meshën e shenjtë më ka shtrënguar zemra. E ndjeja se duhej të ndryshoja diçka. Menjëherë kam shkruajtur për ca mbajtëse të reja qirinsh prej metali dhe u kam kërkuar murgeshave në Kallmet të më bëjnë 4 buqeta të reja lulesh. Kisha ka nevojë edhe për t'u lyster me gelqere, gje që do ta bëj vetë. Përse e kam bërë shkollën e pikturës?

"Një shpirt i ndjeshëm dhe besimtar"

15 maj 1905

Sot kam bërë vizitën time të parë pranë një të sëmurit. Më thirren te një burrë i vjetër që po vdiste. Shkova me kalë deri te kasollja. Aty ma mori kalin një burrë. Përmes një dërrë të ulët hyra në dhomën e vetme të kasolles. Në dhomë ishte vetëm një burrë i vjetër, i mbështetur me shpinë për muri, i cili thithte me qetësi një cigare. Hodha sytë përreth për të gjetur të sëmurin, për të cilin isha thirrur, por nuk e pashë. Plaku kishte vërejtur në heshtje vështrimin tim kërkuar. Më në fund më tha: "Unë jam i sëmur!" Isha pothuajse i nevrkosur pasi kur më thirren për të vizituar të sëmurin, ndodheshin në krevat i shtrirë dhe i lodhur nga ethet. Kisha ecur me kalë për rreth dy orë i prekur nga ethet dhe vij të vizitoj një burrë, i cili ishte më shëndosh se unë. A thua burri po e kuptonte nevrkosjen time? Me duket se po. Ai më ftoi të ulesha pranë tij, ma mori dorën dhe pasi e vendosi tek goja dhe mbi ballë, filloi të më fliste dhe zëri i tij u bë i ëmbël, sikur fshihte në të një lutje të brendshme: "O Zot, unë e shoh që edhe ti je i sëmurë dhe po më dhemb shpirti që të kam thirrur. Por mos u pendo për ardhjen tënde, pasi ajo nuk ka qenë kot. Unë jam duke vdekur dhe dua ta paguaj llogarinë që kam të hapur me Zotin. A e di ti që unë jam një mekatar i madh dhe kur të vijë koha që unë të dal përpara Zotit, nuk e di se çfarë do më shpëtojë përveç se zemërgjerësisë suaj." Unë e dëgjova rrëfimin e tij dhe m'u duk sikur kësaj here kisha bërë mjaft. Ai donte që unë t'i bëja dhe vajimin e fundit. E kundërshtova me vendosmëri, pasi ky sakrament bëhej vetëm për njerëzit që ishin duke vdekur. "Zotëri, më beso, do të vdes së shpejti." Gjatë kësaj kohe erdhen në dhomë dhe të afërmit e burrit, të cilët iu bashkuan lutjes së tij. Edhe ato mendonin se ai do vdiste së shpejti. Nuk isha i

bindur, por i shtyrë nga lutjet e njerëzve, i bëra këtë burri vajimin e fundit. Pas ceremonisë më përgatiten kafe dhe unë qendrova ca kohë duke biseduar me këtë burrë. Ai më tregoi për kohët e shkuara dhe me dukej se i kishte venë qëllim vetes të më tregonte vetëm gjerat negative që kishte bërë gjatë gjithë jetës së tij. Por qëllimi që i kishte vënë vetes nuk pati sukses. Pas çdo fjalie që ai thonte, fshihej një shpirt i ndjeshëm dhe besimtar. Pasi folem rreth një gjysmë ore me njëri-tjetrin, ai hoqi cigaren nga goja, u shtri në tokë, më mori dorën dhe pas disa frymëmarrjeve të zgjatura, vdiq.

"Ishte një përvojë e rrallë për mua"

21 maj 1905

Përsëri një vizitë tek një i sëmurë. Këtë herë ishte një djalë i ri, i cili vuante nga një infeksion akut i mushkërive dhe nuk kishte asnjë shpresë për t'u shëruar. Edhe kjo ishte një përvojë e rrallë për mua. Po përgatitesha t'i bëja vajimin e fundit. Ai po më vështronte i trishtuar dhe m'u lut: "Jam kaq i ri. Të lutem mos e bëj." Në fillim nuk e kuptova, përse ky burrë kaq besimtar, po kundërshtonte këtë sakrament. Vetëm nga bisedat e mëpasshme e kuptova, se ai kishte frikë se mos shërohej përsëri. Shqiptarët besojnë se kur marrin vajimin e fundit janë të destinuar për të shkuar në qiell dhe për këtë nuk lejohet të bëjnë mekate të tjera. Vetëm pas kësaj kuptova përgjigjet që më jepeshin nganjëherë gjatë rrëfimeve kur unë e pyesja si për shembull: "A ke vjedhur?", ato më përgjigjeshin: "O Zot, kam marrë vajimin e fundit, si mund të bëj një mekat të tillë?" Për këtë arsye kishte aq frikë nga ky sakrament ky djalë i ri, pasi ai mendonte që po të kishte një jetë të gjatë, do ta kishte të vështirë t'u rezistonte të gjitha tundimeve të jetës.

"Në dhomën e të vdekurit, mora vendimin..."

që të bëhesha vetë mjek"

26 maj 1905

Ai djali i ri, tek i cili kam qenë dje për vizitë, ka vdekur. Oh, sa më dhemb shpirti, kur shoh se si vdes një gjak i ri. Sigurisht që ai do të kishte shpëtuar, po të kishte pasur mjek dhe ilaçe. Në dhomën e të vdekurit, mora vendimin që të zëvendësoja atë që mungonte dhe të bëhesha vetë mjek. Sikur këto letra të bien një ditë në duar të huaja do të qeshin për optimizmin me të cilin po shkruaj, në lidhje me këtë qëllim që i kam vënë vetes. Të bëhem mjek, kur nuk kam as shkollë, as dije, as përvojë. Nuk do të guxoj të shëroj sëmundjet e komplikuar, por sëmundjet e zakonshme që shërohen me mjete të thjeshta. Këtë do ta bëj. Uroj që për mjetet që na mungojnë, të na japë Zoti i madh, bekimin e tij. Ajo çka forcon bindjen time, është besimi që kanë kur vijnë e më pyesin herë pas here për sëmundjet që kanë.

"Zogjtë thonë lutjen e tyre të mbrëmjes"

14 gusht 1905

Jam ulur para famullisë *me ditarin tim* në dorë dhe po mundohem të përshkruaj ngjarjet e fundit. Por disi nuk më vjen. Pas ditëve të nxehta të verës ka ardhur një mbrëmje e mrekullueshme. Një erë e këndshme lëviz majat e pemëve, gjinkallat gumëzhijne nga të gjitha anët, ndërsa zogjtë thonë lutjen e tyre të mbrëmjes. Por ajo çfarë më tërheq më shumë vëmendjen time është një lutje tjetër e mbrëmjes, e cila këndohet nga disa zogj të tjerë. Ato janë fëmijët e vegjël, vajza dhe djem të cilët kthehen me dhentë e tyre nga kullotat në male. Dhe këndojnë! Janë zërat e tyre të vegjël që përhapen në të gjithë hapësirën. Sa bukur kumbojnë! Para shumë kohësh, në këtë vend ka pasur priftërinj, të cilët i kanë lënë këtij populli këtë traditë të mrekullueshme. Janë këto këngë të shenjta të cilat këndohen kudo sot. Në to perfshihet komplet katekizmi. Krijimi i botës, të gjitha historitë e testamentit të vjetër, jeta dhe vdekja e Krishtit, dhjetë urdhërimet, shtatë sakramentet, me një fjalë të vetme, në të përfshihet gjithçka çfarë një i krishterë i mirë duhet të dije. Vetëm në mund të gjykojmë sot, se sa qetësuese dhe sa mbresëlenëse ka qenë puna e këtyre njerëzve të veshur me rroben e priftit. Është shumë e vështirë të japësh mesime katekizmi këtu, duke marrë parasysht marrëdhëniet e vështira që kanë njerëzit. Prandaj këto këngë janë ndihmë e madhe për mua, pasi këto i dinë të gjithë.



Teksti "Beteja e librave" doli në vitin 1704, si botim anonim, një satirë politiko-teologjike mbi debatin e parësisë së klasicistëve ndaj modernitetit. Por ky libër, vlerësuar për virtuositetin therës, mori menjëherë famë, ku në hyrje shënohet: "Rrëfim i plotë dhe i vërtetë mbi Betejën e zhvilluar të premtën e shkuar midis librave të lashtë e modern në Bibliotekën e Shën Xhejmsit"

# BETEJA E LIBRAVE

nga Jonathan Swift

Kushdo që lexon, me syçeltësinë e duhur, shënimet ke përvitshme të kohës, do të gjejë të shkruar se Lufta është pjellë e Krenarisë dhe se Krenaria është bijë e Kamjes. Dhe nëse pohimi i parë mund të pranohet sakaq, askush nuk mund të pajtohet edhe aq kollaj me Lypësinë e Nevojën, si nga ana e babait, ashtu dhe nga ana e nënës e, ngandonjëherë, as nga ana e nënës dhe as nga ajo e babait. Dhe, me thënë atë që është për të thënë, ngjet rrallë që njerëzit të shamatohen kur livadhisin në të mira; pushtimet rëndom priren nga veriu për në jug, me një fjalë, nga skamja në bollëk. Sheshet më të lashta dhe më të natyrshme të grindjeve janë epshi dhe koprracia që, ndonëse mund t'i marrim për vëllezër a gjërinj të krenarisë, janë, në të vërtetë, bijime të nevojës. Sepse, për të folur me gjuhën e shkrintarëve të politikës, ne mund të vëzhgojmë në Republikën e Qenve (që, pas gjase, në ballë paskësh qenë një institucion i Shumicës) se i gjithë shteti bie kurdoherë në fashë pas një shujte të mirë dhe se luftërat civile ndizen vetëm kur ngjet që ndonjë kockë e madhe të bjerë në gojë të njerit prej qenve prijës, që o e ndan me një pakicë syresh dhe kësisoj, shket në oligarki, o po e mban të tërin për vete, duke rendur me vërtik drejt tiranisë.

Kjo mund të thuhet edhe për ato shemëri që ndizen nga ardhangia e ndonjë bushtre. Sepse e drejta e zotërimit (meqenëse gjasat për të vënë kamje në një t'atillë rast me zarar janë fare të pakta) ngjall aq shumë smirë e dyshime, sa e gjithë bashkësia e asaj rruge katandis në derexhenë e një luftë të hapur dhe çdo


qytetar lufton kundër të gjithëve, derisa më trimoshi, më i shkathëti a më i fatosuri ndër ta, e mbërthen e i gëzohet presë: në këtë e sipër, do s'do, nxjerr krye edhe smira e lakmia, dhe kundër qenit të lumtur zënë hungërimet. Po prapë, në vrojtofshim secilën prej këtyre republikave të zëna me luftë, qofshin këto pushtime a luftëra për vetëmbrojtje, do të vëmë re se po ky arsytim do të na vlejë edhe për arsyet dhe shkaqet e çdo lufte, dhe se skamja e nevoja, në një shkallë a tjetrën (qoftë kjo e vërtetë a e përfytyruar, gjë që në këtë rast është e njëjta gjë) zë kryet e vendit, ashtu si dhe krenaria, në rolin e mujsharit.

Tashti, kushdo që mund të përdoret në këtë skemë e, për më tepër, arrin të rrëgojë a t'ia përshtasë një Shteti Intelktual a një Republike Dijeje, pas një grimëhere do të shquajë rrënjën e grindjes midis dy palëve të mëdha tanimë në luftë dhe do të nxjerrë përfundime të vyera për vlerat e kauzës së gjithsecilit. Mirëpo as zhvillimi dhe as pasojat e kësaj lufte nuk janë edhe aq të thjeshta sa ç'mund të pandehet; sepse grindja e tanishme është mahisur aq keq prej kokave të nxehta të secilës palë dhe mëtimet janë aq të tepruara, sa nuk lënë shteg as për fillimin e bisedimeve të ujdisë. Kjo grindje (sikundër ma ftilloi me gojën e tij një banor i moçëm i atyre anëve) në krye u ndez për një ngastër të vogël toke, që na qenkësh mbi njëren prej dy majave të kodrës Parnas, më e larta dhe më e madhja prej të cilave paska qenë, me ç'duket, qysh prej kohësh që s'mbahen mend, në zotërimin e paqtë të ndofarë banorëve të quajtur të Lashtë; maja tjetër përbehej prej Modernëve. Po këta,

meqenëqë nuk e kishin me sy të mirë vendbanimin e tyre, shpunë ambasadorë tek të Lashtët për t'u qarë për hallin e madh që u kish rënë në kokë; maja e asaj ane të Parnasit u zënkësh krejt pamjen, sidomos nga Lindja; dhe, ndaj, për t'u shporrur luftës, i vinin të zgjidhnin: ose të Lashtët të kishin mirësinë të zhvendoseshin përposh, në majën më të ulët, të cilën Modernët do t'ua lëshonin me dëshirë, për t'u ngjitur ata vetë në vendin e tyre; ose po, në të kundërtën, të sipërthënit të Lashtët do t'i shtrëgonin të vinin vetë me kazma e lopata, për ta dystuar të sipërpërmendurën kodër aq sa të shihnin ata të nevojshme. Të Lashtët u kthyen gjegjme e u thanë se nuk e kishin pritur një mandatë si kjo nga një koloni, të cilën ata e patën pranuar si me pahir që të përbunte aty pranë. Se, sa për vendbanimin e tyre, aty ata ishin anas, ndaj dhe t'u flisje atyre për zhvendosje a nënshtrim ish një gjë që s'kish ku të rrinte.

Se, nëse lartësia e kodrës së tyre u zënkësh pamjen Modernëve, për këtë ata nuk kishin hiç ç'të bënin; veçse dëshironin që Modernët t'i thërrisnin mendjes, vallë ai dëm (në qe vërtet i tillë) nuk u shpaguej me dorë të hapët prej hijes e strehës që u truante. Se, ndofta ata nuk e dinin, por të kërkoje ta sheshoje a gërryeje atë majë ishte barabar një budallallëk me brirë, meqenëse ajo anë e kodrës na paskësh qëlluar një shkëmb i breshtë, që do t'ua copë e çikë almiset dhe zemrat, pa pësuar vetë asnjë qeder. Se ndaj ata i këshillonin Modernët që, në vend që të endërronin të dystonin anën e të Lashtëve, të ngrinin më mirë anën e tyre; për këtë punë, ata jo vetëm që do t'u jepnin leje, por edhe do t'u ndihnin me ç't'u vinte nduarsh. Mirëpo kjo u hodh poshtë me zemëratë të madhe prej Modernëve, që ngulnin këmbë në të mësipërmet. Dhe, kështu, shkaku i kësaj mosmarrëveshjeje, shpërtheu një luftë e gjatë e kryeneçe që mbahej më këmbë, më njëren anë, nga vendosmëria dhe kuraja e ca pak kapedanëve e besëlidhësve e, më tjetrën anë, nga mizëria e madhe që, me gjithë humbjet, nuk kishte të sosur. Në shamatosje e sipër u shteruan rrëke të tëra mellani dhe egërsia e palëve u mbufat pun'e madhe. Tashti, ju duhet ta dini se mellani është kryearma e betejave të diçmëve; e bartur prej një hallati të quajtur pendë, ai hidhet rrebesh mbi armikun prej trimoshëve të secilës anë, me shkathësi e mujshi njëherësh, si të qe një punë ferrëgjatësh. Këtë lëng të djallësor, inxhinieri që e sendërgjoi, e përftoi prej dy përbërësish, vrerit dhe gurkalit, që me hidhësinë dhe helmin e tij t'i përshtatej njëfarësoj dhe të nxiste gjeninë e ndërluftuesve. Dhe, ashtu si grekët qëmoti, që, kur nuk mund të binin në një mendje për fitoren e një betejeje, ngrinin në të dyja anët trofetë përkatës, në mënyrë që pala e mundur të kënaqej dhe të ngushëllohej me një t'atillë çmim (një zakon sa i lavdërueshëm, aq edhe i moçëm, i përtërirë për fati tani së voni në artin e luftës), kështu edhe diçmit, pas një grindjeje të shkurtër e të gjakshme, varën edhe ata trofe në të dyja anët, sido që ende nuk dihej se nga do të anonte fitorja. Këta trofe kryesisht vënë në spikamë vlerat e kauzës, bëjnë një përshkrim të plotë e të paanshëm të betejës dhe përpallin me të madhe fitoren e palës që i ka ngritur. Bota i njeh me gjithfarë emrash, si polemika, argumente, vetëmbrojtje, gjykime të shkurtra, përgjigje, kundërpërgjigje, vërejtje, përsiatje, kundërshtime, përgënjeshtime. Ata vetë apo përfaqësueset e tyre, varen për ca ditë faqazi botës, që t'i bëjnë shir kalimtarët; së këndejmi, më të rëndësishmet dhe më të mëdhatë barten në dofarë magazesh, që i thërresin biblioteka, për t'u ujditur në një kthinë të caktuar enkas për ta dhe që ahëre e tëhu zënë e thërriten *Libra polemikë*.

Në këta libra ruhet mrekullisht fryma e çdo kreshniku të gjallë; pas vdekjes, shpirti i tij mërgon atje për t'i gjallëruar. Ky, së paku, është mendimi i gjithmbarshëm; unë për vete jam i mendimit se shpirti mënon në bibliotekë, ashtu si në çdo varrezë tjetër, ku, sipas disa filozofëve, një frymë që ata e quajnë *brutum hominis*, përsillet përmbi përmendore gjersa trupi të prishet e të kthehet në pluhur, dhe se paskëtaj shuhet a tretet përfare. Kështu pra, një shpirt i trazuar ysht çdo





Jonathan  
Swift

## Beteja e librave



ZENIT  
EDITIONS

libër, derisa ta ketë mbuluar pluhuri a ta kenë ngrënë krimbat, gjë që cave mund t'u ngajë në krye të ca ditëve, ndërsa të tjerëve më vonë; ndaj edhe librat polemikë, duke qenë, ndër të gjithë, të yshtur prej frymëve më të trazuar, kyçen ngaherë në një strehë të veçuar; dhe, nga frika e mujshisë së ndërsjellë, stërgjyshërit tanë e panë të udhës që, për hir të paqes, t'i lidhnin me veriga të rënda hekuri. Për këtë sendërgjim u bë sebeb një ngjarje që do t'jua rrëfej tani. Kur veprat e Skotit dolën së pari në dritë, ato u bartën në bibliotekë dhe u kyçen në një kthinë; por, ende sa pa zënë vend mirë, autori ynë na i vajti për vizitë të zot, Aristotelit, dhe atje të dy ranë në godi të mbërthenin Platonin dhe ta dëbonin me përdhunë nga vendi i tij i lashtë midis të hyjshmëve, ku kish banuar paqësisht për si ndonja tetëqind vjet. Sulmi vajti fjollë dhe, qysh prej asaj kohe, të dy uzurpatorët kanë sunduar të patrazuar në këmbë të tij: por që të ruhej edhe paskëtaj qetësia, u pa e udhës që polemikat më të vëllimshme të mbaheshin në zinxhirë.

Kësisoj, do s'do, do të ish ruajtur qetësia publike e bibliotekave, sikur këtyre viteve të mbrame të mos qe shfaqur një xhins i ri librash polemikë, mbrusur

“

**Kjo grindje (sikundër ma ftilloi me gojën e tij një banor i moçëm i atyre anëve) në krye u ndez për një ngastër të vogël toke, që na qenkësh mbi një rënë prej dy majave të kodrës Parnas, më e larta dhe më e madhja prej të cilave paska qenë, me ç'duket, qysh prej kohësh që s'mbahen mend, në zotërimin e paqtë të ndofarë banorëve të quajtur të Lashtë; maja tjetër përbehej prej Modernëve.**

me më të ligën frymë, nga shkaku i luftës së sipërpërmendur midis diçmëve për majën më të lartë të Parnasit.

Kur këta libra u shpunë përsëpari në bibliotekat publike, më kujtohet një rast t'u kem thënë ca njerëzve të kureshtur se isha fare i bindur që, po të mos i bënim sytë katër, ata do të krijonin trazira ngado që të venin; dhe andaj i këshillova që kampionët e secilës palë t'i linin o bashkë o t'i nakatosnin, ashtu siç bëjmë me helmet, që me urrejtjen e tyre të mund të helmatisnin vetëm sho-shokun. Dhe, sikundër duken bathët, nuk qeshë as profet i keq dhe as këshilltar për t'u përbuzur; sepse qe pikërisht shpërfillja e këtij paralajmërimi ai që u bë sebeb për përleshjen e kobshme që plasi të premten e shkuar midis librave të lashtë e atyre modernë në Bibliotekën Mbretërore. Tashti, meqë biseda për këtë betejë është ende në gojën e gjithsecilit dhe meqenëqë kërshtëria e qytetit është kaq e madhe për të mësuar hollësitë, unë, duke qenë zot i të gjitha cilësive që i lipsen një historian dhe ngase nuk e mbaj me hatër asnjërin prej palëve, e mblodha t'ia vë veshin këmbënguljes së miqve të mi që të ulem e të shkruaj një rrëfim të plotë e të paanshëm.

Kujdestari i Bibliotekës Mbretërore, njeri i vyer shumë, po, para së gjithash i përmendur për njerëzillëkun e tij, qëlloi përkrahës i flaktë i Modernëve; gjatë një beteje në Parnas ai u zotua të shtrinte përdhe me duart e tij dy prej kapedanëve të të Lashtëve, që vigjilonin mbi një qafë të ngushtë majë shkëmbit më të epërm; veçse kur deshi të kacavarej, ashtu i dhjamur sikundër qe, ra plasur në bythë, tipar ky që i pengon së tepërmi ata të palës së Modernëve, sepse, duke qenë fyçkë nga trutë, ata të kanë një zhdërvjelltësi të mrekullueshme arsytimi dhe nuk ua qas mendja të ketë lartësi që mos mund të ngjisinin; ama kur e do puna të kalojnë nga të thënat në të bëra, ndiejnë një shtrëngesë të madh në të ndenjura e thembra. Si i doli huq shestimi, kampioni i zhgënjyer shfreu dufin e zemrës kundër të Lashtëve, duke dëftuar të gjitha shenjat e përkrahjes ndaj librave të armiqve të tyre dhe duke i ujdur këta në apartamentet më të bukura; teksa, në të gjithë këtë kohë, çdo libër që guxonte ta dëftonte veten përkrahës i të Lashtëve, u varros për së gjalli në ndonjë qosh të errët, me kanosjen e pakëndshme mbi krye se mund të flakej në udhë të madhe. Për më tepër, në këtë e sipër një ngatërrim i çuditshëm i vendeve të librave, për të cilin prunë disa arsye. Ca i vunë fajin një kapice të madhe pluhuri dituror, që një puhizë e mbrapshtë na e rrëmbeu prej një rafti të Modernëve, duke e shpënë drejt e në syrin e kujdestarit. Të tjerë thoshin se atij ia kishte ënda t'ua mblidhte krimbat shkollarëve, për t'i llufitur taze' kështu, ca pak iu zdirgjën në shprekë, të tjerët iu ngjitën në kaploqe, për nakatosjen e madhe të të dyjave. Dhe, së fundmi, meqenëse disa vijuan të zvarriteshin nëpër terrin e bibliotekës, ai e humbi toruan fare; ndaj dhe sështë çudi që ua ngatërronte vendin librave, duke ngjeshur Dekartin bri Aristotelit; Platoni i ngratë e pa vetën midis Hobsit dhe Shtatë Mjeshtërve të Urtë, kurse Virgjili u ngjesh mes Draidënit me një rënë anë dhe Uidhërsit më tjetrën.

Ndërkaq, ata libra që përkrahnin Modernët, zgjodhën një prej të vetëve që të zabrahamiste nëpër bibliotekë, për të llogaritur numrin dhe fuqinë e partisë së tyre, si dhe për të bashkënduar punët. Kasneci i kreu të gjitha porosinë me zell të parrëfyer dhe u kthye me një listë të forcave të tyre, gjithë-gjithë pesëdhjetë mijë, që përbëheshin kryesisht nga kalorësia e lehtë, këmbësoria e rëndë dhe mercenarët; nga këta më keq dhe të veshur për ibret; kalorësisë, sido që e madhe në numër, i mungonte fare shpirti luftarak; megjithëqë, ca të pakë, nga tregtia me të Lashtët, ishin pajisur njëfarësoj.

Teksa punët po mahiseshin kësisoj, grindja arriti kulmin; fjalë të rrëmbyera ndiheshin nga të dyja anët dhe mëria po harlisej si s'ka më mirë. Këtu, një kryeqyq i Lashtë, i ngjeshur midis një rafti të tërë me Modernë, u ofrua haptazi ta pleqëronte çështjen dhe të provonte shkoqur se parësia u takonte atyre vetë, shkaku i sundimit të gjatë, maturisë, lashtësisë e, mbi të gjitha, shkaku i meritave të mëdha që kishin karshi Modernëve. Por Modernët u binin hasha premisave dhe u dukej një çudi e patreguar se qysh të Lashtët mund të ngulnin këmbë në lashtësinë e tyre, kur ishte e qartë si drita e diellit (meqë arriti puna gjer këtu) që Modernët ishin ku e ku më të lashtë se ata. Për sa u përket borxheve që na i paskëshin të Lashtëve, ata nuk qasin asnjë për bë. "Është e vërtetë", - thanë, se ca pak anëtarë të partisë sonë janë dëftuar aq të fëlliqur sa të huajnë mëngojën e tyre sipas jush, por të tjerët, pambarimisht më të shumë në numër (e, sidomos në frengtë dhe anglezët), qenë aq larg nga ndjekja e një shembulli kaq të ulët, sa kurrë ndonjëherë nuk kishin begenisur, gjer më tani, të huanin, gjithë-gjithë, as gjashtë fjalë syresh. Sepse kuajt ne i kemi nga të stallës sonë, armët nga të kovaçhanave tona dhe petkat nga të prestarisë sonë. Platoni u ndodh në raftin përbri dhe duke parë që ligjëruesit ishin të leckosur dhe në ngushticën e përmendur si më sipër, - me gërdalla kockë e lëkurë, armë të kalbura druri, parzmakë të ndryshkur dhe pa gjë në bythë, pos rreckave, - u gajas e ashtu gjithë lezet, u përbe të madhe dhe tha se, për Perëndi, u zinte besë.

Përktheu: Azem Qazimi  
Fragment nga libri "Beteja e librave",  
botimet "Zenit", 2018





YLLJET ALIÇKA

# Metamorfoza e një kryeqyteti

Onufri Roman

